

URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE
BOTIMI SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE
NR.134 GUSHTI 2019



REDAKSIA:

KRYEREDAKTOR

Syrja Xhelaj

REDAKTORË

Nuri Çuni
Kujtim Boriçi

KORRESPONDENTËT

Jakup Gjoca - Greqi
Eugen Shehu - Zvicër
Përparim Kapllani - Kanada
Agim Cani - Gjermani
Enea Muhameti - Itali

KONSULENTË

Arian Leka
Zenel Anxhaku
Blerina Harizaj
Agim Zeka
Besnik Anxhaku

DESIGN

Studiograf "A&N"

**SHTYPET NË
SHTYPSHKRONJËN**

"Urtësia
Bektashiane"

Gusht, 2019



Dit' pelegrinazhi masiv në Tomorrin mistik



Një promocion i dendur mediatik paraprakisht e në vazhdim, një dekor i veçantë e funksional dhe mbi të gjitha një fluks më i madh besimtarësh vendas dhe të huaj (qindra mijë sipas medieve) si dhe më shumë trupa artistike, ishin të veçantat e pelegrinazhit të këtij viti në Malin e Tomorrit.



Të bashkohemi në prioritetet e lirisë fetare

Respekti i lirisë fetare është një nga aspektet më të rëndësishme të demokracisë dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar. Në këtë numër, diskutim dhe diskutim të lirisë fetare në prioritetet e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në këtë numër, diskutim dhe diskutim të lirisë fetare në prioritetet e bashkëpunimit ndërkombëtar.

... dhe diskutim të lirisë fetare në prioritetet e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në këtë numër, diskutim dhe diskutim të lirisë fetare në prioritetet e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Të bashkohemi në prioritetet e lirisë fetare

Me ftesë të Institutit për paqe në Uashington, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, mori pjesë para disa kobe, në ministerialin ku u diskutua më së shumti për bashkëpunimin e ideve ...




ENTUSIAZËM PËR ARRITJET TUAJA!

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, mori pjesë në një konferencë të lirisë fetare në prioritetet e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në këtë numër, diskutim dhe diskutim të lirisë fetare në prioritetet e bashkëpunimit ndërkombëtar.

... dhe diskutim të lirisë fetare në prioritetet e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në këtë numër, diskutim dhe diskutim të lirisë fetare në prioritetet e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Entusiasëm për arritjet tuaja!

Përpara disa ditësh, Kryegjyshi Botëror Bektashian, priti në Seli në Tiranë, znj. Mariyam Cementwala, këshilltare e politikave dhe nismave strategjike për çështjet e lirisë së besimit në Departamentin Amerikan të Shtetit, me kërkesë të kësaj të fundit.




Të dashuruarit në bektashizëm

... dhe diskutim të lirisë fetare në prioritetet e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në këtë numër, diskutim dhe diskutim të lirisë fetare në prioritetet e bashkëpunimit ndërkombëtar.

... dhe diskutim të lirisë fetare në prioritetet e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në këtë numër, diskutim dhe diskutim të lirisë fetare në prioritetet e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në Shembërdhenj, ku bektashizmi ka rrënjë të lashta

Zig-zaget e rrugës që gjarpëron Zshpateve të një pas njëshëm, të veshura me pyje e gjelbërim, për në teqenë e njohur të Shembërdhenjit, të duken si më 'të buka' kur shikon automjete të shumtë që mëngjesin e 6 gushtit 2019...



SHPIRTI I DILRË I IMAM HYSENIT A.S

... dhe diskutim të lirisë fetare në prioritetet e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në këtë numër, diskutim dhe diskutim të lirisë fetare në prioritetet e bashkëpunimit ndërkombëtar.

... dhe diskutim të lirisë fetare në prioritetet e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në këtë numër, diskutim dhe diskutim të lirisë fetare në prioritetet e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Shpirti i dilrë i Imam Hysenit a.s

Beteja në shkretëtirën buzë Euftratit Bishte në zgrip. I larti Imam Hysen, kur pa se të gjithë shokët e vëllezërit iu vranë, i mbetur vetëm në fushën e mjerruar të Qerbelasë, rënkoj aq shumë sa e dëgjoj qielli dhe toka.



Dit' pelegrina Tomorrit



Kujtim BORIÇI
Nuri Çuni

Një promovion i dendur mediatic para-prakisht e në vazhdim, një dekor i veçantë e funksional dhe mbi të gjitha një fluks më i madh besimtarësh vendas dhe të huaj (qindra mijë sipas medieve) si dhe më shumë trupa artistike, ishin të veçantat e pelegrinazhit të këtij viti në Malin e Tomorrit. Njëko-

hësisht, paqëtimi, shtimi i dashurisë e adhurimit për të Madhin Zot, rritja e shpresës për të ardhmen, ishin e mbeten ato që përjetuan besimtarët në përfundim të këtij evenimenti të rrallë në krejt kontinentin tonë. Kishte dit' që fluksi i pelegrinëve që rrugëtonte drejt malit të Tomorrit, për të arritur pikun më 22 gusht 2019, ditë në të cilën u zhvillua dhe ceremonia zyrtare. Këtë vit, kishte më shumë dhe gazetarë dhe të huaj që ndoqën nga afër këtë festë të mrekullisë bektashiane, bashkëkombas që vinin jo vetëm nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi e dhjetëra vende ku

zhji masiv në n mistik



punojnë e jetojnë shqiptarët, por dhe shtetas të kombeve e kombësive të tjera nga Kanada, Turqia, Greqia, Australia e largët, Italia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Suedia, Franca, Gjermania, Suedia, Çekia, Sllovakia, Irani, Spanja, Polonia etj...

Për të gëzuar me besimtarët në këtë festë bektashiane kishin ardhur dhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Shkëlqesia e Tij z. Ilir Meta; Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedoni së Veriut, z. Talat Xhaferri; Kryetar i Partisë 'Xhe He Pe' të Turqisë, z. Kemal Kiliçdaroglu; Kryetar i Bashkisë së Skraparit,

z. Adriatik Mema; Ministri i Qeverisë së Shqipërisë Blendi Klosi; përfaqësues të ambasadave të huaja të akredituara në Tiranë; klerikë bektashianë nga Shqipëria e jashtë sajë; përfaqësues të besimeve të tjera fetare; drejtues të medieve të ndryshme kombëtare dhe nga jashtë vendit etj...

Ceremoninë e parapriu dhe përrurimi i bustit të një prej klerikëve të shquar bektashianë, Baba Ali Tomorrit, vepër e skulptorit të talentuar Muntaz Dhrami, financuar nga biznesmeni Pëllumb Salillari, vendosur në hyrje të godinës së teqesë.



Në lartësinë e këtij mali, ne kemi gjithashtu shenjtorin tonë, Abaz Aliun. Pavarësisht legjendave shumë shekullore që tregohen e transmetohen për 'Të nga brezi në brez, Ai vetë është një realitet i mrekullueshëm i burrërisë përpara frikës, i jetës përpara vdekjes, i dashurisë para urrejtjes, i pastërtisë shpirtërore përballë shpurës së Jezidëve. Ai ka qenë dhe do të mbetet modeli i burrit dhe i trimit që u identifikua deri në fund me vetë ndërgjegjen e shkëlqyer të Imam Hysejnit, paqja e Zotit qoftë me 'Të! Emri dhe vepra e Abaz Aliut, i kanë falur këtij kryemali të shqiptarëve, jo vetëm shenjtërinë e historisë, por edhe vlera të jetës që kemi jetuar dhe jetojmë. Ato kanë qenë dhe do të mbeten burime të kristalta të mendimeve dhe qëndrimeve tona, përballë realiteteve aq problematik që po kalon Shqipëria, Ballkani e më gjerë sot, duke na bërë të reflektojmë që të gjithë, për më shumë shpresë e dashuri, paqe e mirësi, besim e adhurim për Krijuesin. Jeta e Abaz Aliut, sikundër jeta dhe vepra e krejt dervishëve dhe baballarëve tanë nëpër vite, është dhe do të mbetet një model për çdo besimtar, për çdo ndjekës dhe dashamirës të udhës së ndritur të Haxhi Bektash Veliut.

I pari e hapi ceremoninë Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimajn, i cili ndër të tjera tha: "Së pari, në cilësinë e Kryegjyshit Botëror Bektashian, më lejoni t'ju falënderoj të gjithëve ju, që keni marrë sot rrugën e vështirë të malit të Tomorrit, për t'iu bashkuar gëzimit të këtij pelegrinazhi historik. Zoti qoftë i kënaqur me ju dhe familjet tuaja, duke iu plotësuar çdo dëshirë që keni në këtë jetë! Së dyti, dua të shpreh kënaqësinë për këtë pjesëmarrje masive në këtë rit të shënuar e, mbi të gjitha, për gëzimin dhe shpresën që shoh në sytë dhe zemrat tuaja, që është shprehje e devocionit për t'u përlurur plot mirënjohje dhe krenari, përpara mezareve të dervishëve dhe baballarëve bektashianë, të cilët e mbajtën të gjallë në shekuj frymën e lirisë dhe të besimit në Zot. Ata ushqyen shpresën e pafund se, pas çdo brengje e dhimbjeje, pas çdo gjëme apo fatkeqësie, do të bëhej, vullneti i Zotit dhe do të lindnin rreze dielli edhe për ta. Prandaj, rrugët e këtij mali të shenjtë, prandaj sheshet e kësaj teqeje ku mblidhemi çdo vit, u mbushën kurdoherë me hapat dhe zërat e besimtarëve, me optimizmin në vite të vështira që kalonte Shqipëria. Në lartësinë e këtij mali, ne kemi gjithashtu shenjtorin tonë, Abaz Aliun. Pavarësisht legjendave shumë shekullore që tregohen e transmetohen për 'Të nga brezi në brez, Ai vetë është një realitet i mrekullueshëm i burrërisë përpara frikës, i jetës përpara vdekjes, i dashurisë para urrejtjes, i pastërtisë shpirtërore përballë shpurës së Jezidëve. Ai ka qenë dhe do të mbetet modeli i burrit dhe i trimit që u identifikua deri në fund me vetë ndërgjegjen e shkëlqyer të Imam Hysejnit, paqja e Zotit qoftë me 'Të! Emri dhe vepra e Abaz Aliut, i kanë falur këtij kryemali të shqiptarëve, jo vetëm shenjtërinë e historisë, por edhe vlera të jetës që kemi jetuar dhe jetojmë. Ato kanë qenë dhe do të mbeten burime të kristalta të mendimeve dhe qëndrimeve tona, përballë realiteteve aq problematik që po kalon Shqipëria, Ballkani e më gjerë sot, duke na bërë të reflektojmë që të gjithë, për më shumë shpresë e dashuri, paqe e mirësi, besim e adhurim për Krijuesin. Jeta e Abaz Aliut, sikundër jeta dhe vepra e krejt dervishëve dhe baballarëve tanë nëpër vite, është dhe do të mbetet një model për çdo besimtar, për çdo ndjekës dhe dashamirës të udhës së ndritur të Haxhi Bektash Veliut. Ky pelegrinazh i sotëm, që vjen pak ditë pasi ne kujtuam dhe ditën e bekuar të

PRESIDENTI META: Kënaqësi të shoh sot më shumë besimtarë dhe mysafirë të nderuar, të cilët janë bashkuar me ne në këtë Festë të Shenjtë, këtu në malin e Tomorrit. Kjo është shenjë e mirë që punët në vitin që vjen do të shkojnë më mirë për vendin tonë dhe në të gjitha hapësirat tona, me ndihmën e Abaz Aliut. Ndaj edhe ne mbledhemi çdo vit këtu në malin e Tomorrit për të nderuar jo vetëm këtë figurë të shenjtë, por për të nderuar të gjithë ato legjenda, personalitete dhe baballarë, të cilët përmes bektashizmit bënë dhe bëjnë më të mirën për Shqipërinë dhe për çështjen tonë kombëtare. Për të nderuar gjithashtu të gjithë ata të cilët bënë gjithçka për gjuhën shqipe, për të nxitur lëvizjet për çlirim dhe bashkim kombëtar, të cilët punuan gjithmonë pa u lodhur për të forcuar harmoninë ndërfaqetare në vendin tonë. Poeti ynë i madh kombëtar, Naim Frashëri, në momentet më të vështira dhe më të dëshpëruara të mbarë kombit për t'i dhënë fuqi shqiptarëve, për t'i zgjuar dhe për të pasur më shumë vetëbesim iu referua dhe i dha vendin të cilin meritonte edhe në poezi figurës madhështore të Abaz Aliut



Kurban Bajramit, për nga pjesëmarrja, mesazhet që përcjellin, ritet, bashkë-kuvendimi me njëri-tjetrin, pa dallim race, gjinie, kombësie, etniteti, është një vlerë tjetër paqeje, adhurimi dhe angazhimi për ditë më të mira në të ardhmen. Kam besimin e plotë tek bekimi i të madhit Zot, se ky eveniment do e bëjë më të dëlirë e më të paqtë shpirtin tonë, do na bëjë më të fortë shpirtërisht e fizikisht, me energji më të pastra e më të plota, duke i vënë ato në shërbim të njerëzve dhe kombit. Ne të gjithë e dimë se shoqëria njerëzore sot po përballet me disa sfida, që lidhen me botëkuptime e me probleme sociale, ku lakmia, c'mira e Jezidit, po lufton ashpër kundër paqes, dashurisë njerëzore e mirësisë universale. Shpesh aktet e dhunshme, konfliktet e përgjakura në botë, disa tendenca nga grupime apo qarqe të caktuara për të përcjellë mesazhe lufte e konfliktesh, duke i veshur ato padrejtësisht me rregullat e besimeve fetare. Deviza bektashiane "Pa atdhe nuk ka fe", predikimi i harmonisë njerëzore, vëllazërisë së sinqertë, dashurisë për Zotin, kërkojnë një mbështetje sa më masive të klerikëve, besimtarëve, politikanëve, në mënyrë që spektri i harmonisë njerëzore në këtë botë mbi tokë, të ketë një shtrirje sa më të gjerë shpirtërore

e territoriale. Ne bektashinjtë, kudo që jemi në botë, do vazhdojmë të jemi në krye të këtij misioni që kemi para Krijuesit dhe shoqërisë. Kënaqësia jonë shtohet kur konstatojmë se nga viti në vit, sikundër ka ndodhur edhe sot në këtë vend të shenjtë, ashtu si dhe vendet e tjera të shenjtë të besimit bektashian, shtohet ndjeshëm numri i pelegrinëve që vijnë, luten e marrin bekimin e shenjtë për hallet e jetës së tyre. Ne ndihemi krenarë sot, jo pse i kujtojmë këta shenjtë, por sepse çdo ditë e jona, çdo hap i yni është një bashkim natyror dhe unik me shpirtin e tyre. Duke dashur Shqipërinë, duke dashur familjen, duke forcuar vëllazërinë tonë tradicionale, ne u afrohem sa më shumë vlerave njerëzore, tipareve të mrekullueshme të profetëve. Ky është dhe do të jetë misioni ynë, edhe në të ardhmen. Më lejoni më këtë rast të falënderoj biznesmenin, Z. Pëllumb Salillari, për sponsorizimin e bustit të një prej klerikëve të shquar bektashianë, Baba Ali Tomorrit dhe skulptorin e talentuar, Z. Muntaz Dhrami. Dhe një herë më lejoni t'ju uroj ju që keni ardhur këtu dhe besimtarëve kudo ku janë nëpër botë: Zoti ju bekoftë të gjithëve! Amin!"

Në vazhdim, ishte Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta që bëri përshëndetjen e rastit. Ndër të tjera, ai theksoi: "Kënaqësi të shoh sot më shumë besimtarë dhe mysafirë të nderuar, të cilët janë bashkuar me ne



shqiptarët e sidomos të rinjtë e të rejat, por edhe të gjithë këta fëmijë të mrekullueshëm të cilët kanë mbushur sot malin e Tomorrit. Na ndihmoftë Abaz Aliu të gjithëve!”

Me interes u prit dhe fjala përshëndetëse e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedoni së Veriut, z. Talat Xhaferri. ”Jam shumë i lumtur sot që më jepet mundësia të marr pjesë sot në këtë vend të shenjtë, në malin mistik të Tomorrit, në këtë ceremoni tradicionale të përvitshme të bektashinjve. Me këtë rast dua të përshëndes nga ky vend i Abaz Aliut Kryegjyshin Botëror Haxhi Dede Edmond Brahimaj, Presidentin e Republikës së Shqipërisë z. Ilir Meta si dhe gjithë

në këtë Festë të Shenjtë, këtu në malin e Tomorrit. Kjo është shenjë e mirë që punët në vitin që vjen do të shkojnë më mirë për vendin tonë dhe në të gjitha hapësirat tona, me ndihmën e Abaz Aliut. Ndaj edhe ne mblidhemi çdo vit këtu në malin e Tomorrit për të nderuar jo vetëm këtë figurë të shenjtë, por për të nderuar të gjithë ato legjenda, personalitete dhe baballarë, të cilët përmes bektashizmit bënë dhe bëjnë më të mirën për Shqipërinë dhe për çështjen tonë kombëtare. Për të nderuar gjithashtu të gjithë ata të cilët bënë gjithçka për gjuhën shqipe, për të nxitur lëvizjet për çlirim dhe bashkim kombëtar, të cilët punuan gjithmonë pa u lodhur për të forcuar harmoninë ndërfaqetare në vendin tonë. Poeti ynë i madh kombëtar, Naim Frashëri, në momentet më të vështira dhe më të dëshpëruara të mbarë kombit për t’i dhënë fuqi shqiptarëve, për t’i zgjuar dhe për të pasur më shumë vetëbesim iu referua dhe i dha vendin të cilin meritonte edhe në poezi figurës madhështore të Abaz Aliut: ‘Abaz Aliu zu’ Tomorr, / Erdhi afër nesh, / Shqipëria s’mbet e gjorë, / Se Zoti e desh!’. Ndaj duke falënderuar Kryegjyshin Botëror për këtë organizim madhështor, dua t’ju uroj të gjithëve ju që keni ngjitur sot malin e Tomorrit, të gjithë besimtarëve bektashi dhe të gjithë shqiptarëve kudo ndodhen, suksese dhe mbarësi në familjet tuaja. Abaz Aliu të na japi forcë të gjithëve në rrugën tonë për një Shqipëri më të drejtë, për një Shqipëri më të bashkuar, për një Shqipëri të vërtetë europiane, siç e meritojnë të gjithë

bashkëkombasit tanë kudo që janë, në emrin tim personal dhe në Emër të Kuvendit të Maqedonisë së Veriut. Kam para syve faktin se feja është faktor i rëndësishëm i bashkimit të shqiptarëve kudo që janë, ajo predikon paqe, mirësi, vëllazëri e bashkim,





Z. TELAT XHAFERRI: ... Në malin mistik të Tomorrit, në këtë ceremoni tradicionale të përvitshme të bektashinjeve. Me këtë rast dua të përhëndes nga ky vend i Abaz Aliut Kryegjyshin Botëror Haxhi Dede Edmond Brahimaj, Presidentin e Republikës së Shqipërisë z. Ilir Meta si dhe gjithë bashkëkombasit tanë kudo që janë, në emrin tim personal dhe në Emër të Kuvendit të Maqedonisë së Veriut. Kam para syve faktin se feja është faktor i rëndësishëm i bashkimit të shqiptarëve kudo që janë, ajo predikon paqe, mirësi, vëllazëri e bashkim, me shpresë e besim tek Zoti. Pra, feja është faktor i rëndësishëm për interesin tonë kombëtar shqiptar. Duke punuar vazhdimisht, duke forcuar dashurinë e bashkëpunimin pa dallim feje, besimi, përkatësi politike, duke respektuar tolerancën. Kjo mund të shndërrohet në një realitet të rëndësishëm për realizimi e objektivave tona.

me shpresë e besim tek Zoti. Pra, feja është faktor i rëndësishëm për interesin tonë kombëtar shqiptar. Duke punuar vazhdimisht, duke forcuar dashurinë e bashkëpunimin pa dallim feje, besimi, përkatësi politike, duke respektuar tolerancën. Kjo mund të shndërrohet në një realitet të rëndësishëm për realizimi e objektivave tona. Ashtu siç ka deklaruar dhe Shkëlqesia e Tij, Dede Edmondi, citoj: 'Të pranojmë e punojmë për paqen mes njëri-tjetrit. Të mendojmë e pastaj të flasë duke kërkuar forcimin e dashurisë për kombin, se ndryshe, asnjë politikë nuk është e mjaftueshme për të arritur atë që duam..'. Ne duhet të punojmë duke shpenzuar forca dhe energji më

të mëdha, në mënyrë që tu lemë brezit të sotëm, gjeneratave që vijnë, për domosdoshmërinë e paqes, dashurisë, harmonisë, barazisë, shoqërisë me vlere dhe standarde të shëndosha, me dashurinë e besimin në Zot, në përkushtimin për çështjen kombëtare.... Edhe një herë e theksoj se jam jashtëzakonisht i lumtur që marr pjesë sot këtu, me rastin e festës së shenjtë në Malin e Tomorrit... Gëzuar të gjithë këtë ditë të shënuar!' - theksoi z. Xhaferri.

Edhe për mysafirin e veçantë, Kryetarin e Partisë 'Xhe He Pe' të Turqisë, z. Kemal Kiliçdaroglu, kjo festë bektashiane, ishte krejt e veçantë si nga pjesëmarrja masive, gjeografia e pelegrinëve, interesi i jashtëzakonshëm i medias vendase e asaj të huaj, ritet, mikpritja e organizatorëve dhe shqiptarëve në përgjithësi dhe mesazhet e bashkëjetesës, harmonisë fetare, dashurisë për njëri-tjetrin pa dallime feje, besimi race e etnie që predikon e zbaton besimi bektashian. Ndër të tjera ai kumtoi: "I nderuar President i Republikës së Shqipërisë z. Ilir Meta! I nderuar Kryegjyshi Botëror Bektashian, Haxhi Dede baba Edmond Brahimaj! Zonja dhe zotërinj të pranishëm, ju përhëndes nga zemra.

Në vazhdim të ceremonisë, fjala e përhëndetjes, iu dha Ministrit Blendi Klosi, i cili ndër të thera pohoi: "I nderuar Kryegjyshi Botëror Dede Edmond Brahimaj, i nderuar President i Republikës Meta, i nderuar Kryetar i Parlamentit të Maqedonisë Veriore z. Talat Xhaferri. Të nderuar miq! Kjo ditë pelegrinazhi, është një ditë e shënuar për bektashinjtë, për të gjithë ne që jemi sot këtu e për të gjithë të tjerët. Ky mal, mali i Tomorrit, ka një cilësi që buron nga vetë mirësia që rrezaton besimi bektashian, por dhe nga mirësia e vetë banorëve të kësaj zone. Ndaj dhe në emër të qeverisë e kryetarit të Bashkisë së Skraparit, tu uroj një festë ët shënuar këtu në këtë vend të shenjtë dhe të tjerëve kudo që ndodhen. Dua tu them gjithashtu, se në mbështetje të interesit kombëtar, me angazhimin e faktorëve të komunitetit, me mbështetjen e kryetarit të Bashkisë Skrapar, Çorovodë e Berat, shumë shpejt do të merren hapat ligjorë që Mali i Shenjtë i Tomorrit të mos dëmtohet, të shtohen hapësirat e mbrojtura, në mënyrë që të ruhet kjo natyrë e mrekullueshme dhe të jetë sa më komode dhe në shërbim të besimtarëve që vijnë vazhdimisht



Z. KEMAL KILIÇDAROGLU: Jam shumë i kënaqur që marr pjesë në pelegrinazhin e Malit Tomor, në Shqipëri. Javën e kaluar morëm pjesë në ceremoninë e Haxhi Bektashit dhe sot, jemi këtu duke përkujtuar Abaz Aliun. Me bukurinë shpirtërore të këtij vendi kaq të lartë dhe paqësor, uroj që kjo paqe të shpërndahet në të gjithë rruzullin tokësor. Sot, duke trashëguar paqen, mirësinë e Haxhi Bektashit, jo vetëm në Turqi, por edhe në Shqipëri ka çelur lulja e respektit dhe dashurisë ndaj njeriut. Shembull kundër diskriminimit dhe padrejtësisë, Abaz Aliu është bërë simbol i botës tonë shpirtërore. Ky trëndafil që ka çelur këtu në Malin e Tomorit, është simbol i trëndafilave të tjerë si Sari Salltiku, Haxhi babai, Hasim babai dhe Gul babai, që të gjithë janë duke ujitur me ujin e paqes dhe dashurisë që para 600 vjetëve. Në këtë dritë të përbashkët të kulturës sonë, Mustafa Këlam Ataturku eci po me këtë moto, 'Paqe në vendlindje, sjell paqe në botë'. Pas krijimit të Republikës Turke, Kemal Ataturku, marrëveshjen e parë paqësore e bëri me Shqipërinë. Besoj me shpirt që këta pelegrinazhe që bëhen, qoftë në Anadoll apo në Tiranë; do i forcojnë më shumë lidhjet tona vëllazërore dhe do të vazhdojmë rrugën tonë të përbashkët. Me këtë ndjesi të madhe, u përshëndes të gjithëve me respekt dhe dashuri!"



në këtë vend të shenjtë. Kjo hapësirë u takon banorëve, gjithë shqiptarëve dhe duhet e do të mbrohet nga shkatërrimi, duke qenë vazhdimisht në shërbim të turizmit masiv, turizmit religjioz e gjithë komunitetit. Pra, duke iu bashkuar nismës së komunitetit "Ta mbrojmë malin e Tomorit", ne të gjithë bëjmë atë që duhet bërë. Gëzuar festën e kalofshi një ditë të shënuar me familjarët tuaj..!"

Përshëndetjet e rastit u shoqëruan dhe me dhënie mirënjohje të Kryegjyshit Botëror Bektashian për personalitetet që nderuan këtë event, por edhe me shkëmbime të ndërsjellta dhuratash simbolike.

Ishin grupet artistike popullore që në vazhdim e, pothuaj gjatë gjithë pasdites, deri afër mesnatës, që shpalosën këngë, nefese bektashiane e valle, ku besimtarët u bënë pjesë e reperitorit, duke ja shtuar më tej hijeshinë dhe vlerat kësaj feste bektashiane.



MINISTRIT BLENDI KLOSI, i cili ndër të thera pohoi: "I nderuar Kryegjyshi Botëror Dede Edmond Brahimaj, i nderuar President i Republikës Meta, i nderuar Kryetar i Parlamentit të Maqedonisë Veriore z. Telat Xhaferri. Të nderuar miq! Kjo ditë pelegrinazhi, është një ditë e shënuar për bektashinjtë, për të gjithë ne që jemi sot këtu e për të gjithë të tjerët. Ky mal, mali i Tomorrit, ka një cilësi që buron nga vetë mirësia që rrezaton besimi bektashian, por dhe nga mirësia e vetë banorëve të kësaj zone. Ndaj dhe në emër të qeverisë e kryetarit të Bashkisë së Skraparit, tu uroj një festë ët shënuar këtu në këtë vend të shenjtë dhe të tjerëve kudo që ndodhen. Dua tu them gjithashtu, se në mbështetje të interesit kombëtar, me angazhimin e faktorëve të komunitetit, me mbështetjen e kryetarit të Bashkisë Skrapar, Çorovodë e Berat, shumë shpejt do të merren hapat ligjorë që Mali i Shenjtë i Tomorrit të mos dëmtohet, të shtohen hapësirat e mbrojtura, në mënyrë që të ruhet kjo natyrë e mrekullueshme dhe të jetë sa më komode dhe në shërbim të besimtarëve që vijnë vazhdimisht në këtë vend të shenjtë. Kjo hapësirë u takon banorëve, gjithë shqiptarëve dhe duhet e do të mbrohet nga shkatërrimi, duke qenë vazhdimisht në shërbim të turizmit masiv, turizmit religjuz e gjithë komunitetit. Pra, duke iu bashkuar nismës së komunitetit "Ta mbrojmë malin e Tomorrit", ne të gjithë bëjmë atë që duhet bërë. Gëzuar festën e kalofshi një ditë të shënuar me familjarët tuaj..!"



AY MAL

Nga Mid'hat Frashëri

-E sheh atë mal, biro, atë majë të shkëlqyer? E sheh si ndrit nga dielli? A e vë re qysh kryet i vete gjer në qiell, më lart se retë?

Ay është Tomorri, mali plak i Shqipërisë. Syrin e ka gjithnjë mbi këtë detin tonë. Ecë më të djathtë, biro, ecë më të mëngjër; shko nga fryn veriu i freskët, nga vjen juga e vakur dhe ke për të parë majën e tij, që del mbi malet e tjerë, që ngrihet mbi fushën e gjerë.

Eja, biro, të vemë te mali plak. Edhe im atë ka vajtur atje. Edhe gjyshi im, edhe gjyshi i gjyshit është ngjitur n'atë majë. Më kanë thënë të moçmit, ata që na e kanë ruajtur dhe na e kanë lënë këtë dheun e Shqipërisë, se shkonin atje sipër si në një vend të shenjtëruar, shkonin të vizitonin atë majë të zbardhur dhe të shkëlqyer prej viteve.

...

-Udha po bëhet e rëndë, kam frikë mos lodhemi.

-Ecë, biro, mos shiko gjithnjë përpjëtë: shiko dhe një herë poshtë. Shiko sa udhë kemi marrë, sa jemi ngjitur. Edhe pak kurajë dhe do të jemi në majë.

Ky që përgjigjej kështu, ishte i ati. Të dy kishin marrë udhën e malit, veshur lehtë, me shkop në dorë, me trajsë në kurriz. Djali do ish nga dymbëdhjetë vjeç, i ati nja tridhjetë e pesë.

Edhe po ecin me gëzim, si dy shokë, jo si at e bir. Të dy të shëndoshë, dielli u ka skuqur faqet, një djers' e hollë u njom

ballët e gjerë, të çelur, se kësulën e kanë hedhur prapa dhe flokët dalin nën të, leshra gështenjë si dhe syt' e tyre. Thotë njeriu se janë vëllezër, aq janë të ngjashëm. Një pengesë, një trap për t'u hedhur, një shkëmb përpara udhës, një zog që u priste udhën, një drizë e kërrusur, një vij' e vogël që rrëkëllehej nga brinja e malit, të gjitha këto i vinin në gaz, i bënë të hovnin. Thoshte njeriu se nuk lodheshin, por sa ngjiteshin, aq më tepër fuqi dhe zell të ri gjenin.

...

-Puth dheun, djalë, se jemi në majë të malit. Koka e një mali plak s'mund të shkelet si një kodër e fushës; këtu jemi në prag të qiellit. Mos u tremb, s'na prish kjo erë. S'është'er' e moçalit, as er' e luginës së thellë. Dëbora e qiellit vjen çdo mot dhe e pastron këtë krye të venerishme. Këtu çdo gjë ka bukuri; duhet respektuar si një gjë e bekuar.

...

Shiko tani, djalë! Nuk sheh a? Ja, merri këto qelqe dhe shiko.

-Atë po shoh tani fort mirë; më duket sikur më dhe një palë sy të rinj.

-Janë syt' e zemrës, djalë!

...

-Shiko në të gjith'anët. Këtej sheh Shqipërinë tonë. Më të mëngjër atë det të kaltër, që na pushton gjithë tokën e perëndimit. E sheh si është shtrirë, i qetë dhe i butë? Ky është Adriatiku, blu si një rrobë mëndafshi, i kulluar si një copë qielli.

I sheh ata male atje tej? Thotë njeriu se janë vëllezërit e

këtij plaku të bekuar. Ata janë malet shkëmborë të Shkodrës; janë si një varg ruajtës besnik në mes tonë dhe t'armikut të përjetshëm. Rrëzë tyre është shtrirë, afër atij liqeni të gjatë, Shkodra, e mbuluar me gjetet e drurëvet.

Eja më këtej, djalë! Vëri re mirë kësaj maje, që ngrihet mbi ata male rrëmujë: është mali Kavanjë, afër të cilit ngrihet mali i Skënderbeut. Mos e zërë ngojë kurrë këtë emër të madh, pa një respekt të thellë.

I sheh ata brigje, atje sipër Shkumbinit? Janë malet e Dibrës dhe të Matit, ujitur me shumë gjak shqiptari, gjak të ndershëm dhe të bekuar, që rrodhi për mbrojtjen e mëmëdheut.

...

-Shiko fushën e Myzeqesë, shih Beratin tonë, që shtrihet nën këmbët e Tomorrit, nën hije të tij, me ato kisha të moçme brenda në fortesë.

Kthehu nga jugu. A i sheh atje tej malet e Sulit, të Filatit e të Janinës... E sheh sa e bukur është Janina, mbi atë liqen të kaltër, me atë xhami të bukur mbi fortesë?

- I shoh, at, po shoh edhe ca njerëz, që më duken të huaj.

-Pusho, djalë, mos lëndo një plagë!

Ngjitu tani drejt burimit të Vjosës, të këtij uji të kulluar. Vazhdo fushën e gjerë që kemi nën këmbë, ecë lart atyre grykave t'egra, po të dashura, dil në Pind.

Tani kthehu nga lind dielli në mëngjes dhe shiko mirë djalë, se janë kaq gjëra të vërejtëshme. E sheh Gramozin e madh, me ballët mbuluar me pyll. Andej buron Devolli i uruar, që na shkon këtu pranë. Shih pastaj edhe këto të dy tepsit' e ergjendta? Janë liqenet e këndshëm të Prespës e të Ohrit, me ujë të kulluar si ergjend i derdhur.

Lëre Drinin e vjetër, le të oshëtijë në gryka e në male; lëre të vejë afër Shkodrës. Shiko më tej atë mal të gjatë, më të gjatë dhe më të madh edhe se ky Tomorr; është Shari, madhështor në mes t'atyre fushave pjellore, t'asaj Kosove, që e ujit djersa e atyre njerëzve të shëndoshë dhe të gjallë.

-At, më duket se edhe këtu ca këmbë të huaja...

- Pusho, djalë, mos lëndo një plagë.

Më tej atyre fushave, ata male të vegjël ndajnë dheun e bukur të Shqipërisë prej truallit të huaj.

...

Që të dy po shikonin. Rreth tyre ish një pushim i thellë. Shkëmbinjt' e moçëm thua se kishin vënë veshin dhe po dëgjonin. Nga çdo anë dheu i bekuar po zgjatesh, në fusha në brigje, në male, i vijosur prej lumenjve, me ca njolla të kaltërta si ergjend i derdhur.

Të dy tani dukeshin si të rritur, dukeshin si dy shqiponja të varura në qiell. Dheu u dukesh kaq larg dhe kaq poshtë!

-Merre këtë erë të pastër, biro, se më s'e ke për ta gjetur përposh. Edhe shpes i malevet këtu vjen dhe kërkon fuqi për krahët; shqiponja këtu e mpreh sqepin, kaprolli këtu u jep ujë këmbëvet të çelikt, ret' e qiellit këtu vinë dhe mbushen me shi, dëbora këtu zbardhet, rrufeja këtu e merr zjarrin.

Rri e patundur kjo majë. Ruan Shqipërinë. E ka pushtuar me shikimin e saj.

Djali po dëgjonte i mejtuar me sytë atje larg. Përnjëherë një hije i shkoi përpara syvet:

-At, sa e vogël qenka Shqipëria jonë!

Mos blasfemo Perëndinë!- thirri i ati i keqësuar. Mos poshtëro veprën e të madhit Zot. Kjo Shqipëri që të duket e vogël, është dhurat' e Zotit dhe ka një vleftë të madhe në zemrat tona. Kjo baltë që sheh, është mbujtur me eshtrat e të parëvet tanë, me qindra gjyshër e stërgjyshër, që nga kohët e errëta të shkuara. Këtu në këtë truall kanë shpirtrat dhe eshtrat e tyre të bëra pluhur.

Gjithë të gjallët këtu janë të lumtur a të vuajtur, mbi këtë dhé. Ky dhé, ku është pluhuri i të parëve, kjo baltë mbi të cilën piqet kalliri dhe ngrihet dushku, ky truall ku tringëllin fjala "Zot" në gjuhë të shqiponjës, kjo tokë është Shqipëria jonë, e lënë prej të parëvet në kujdesin tonë, që ta ruajmë, se është' e bekuar, është mëmëdheu ynë.

Sofie, 25.09.1914



Të bashkohemi në prioritetet e lirisë fetare

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, mori pjesë në ministerialin për përparimin e lirisë fetare, organizuar nga Instituti Amerikan për paqe, në Uashington

Me ftesë të Institutit për paqe në Uashington, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, mori pjesë para disa kohe, në ministerialin ku u diskutua më së shumti për bashkëpunimin e ideve dhe institucioneve në kontekstin e lirive fetare.

Një auditor me personalitete të lartë fetarë dhe shtetërorë, me studiues dhe teologë nga të gjitha kontinentet, bëri ç'ishte e mundur, të merrte në analizë të thellë shfaqjet e derisotme të lirive fetare, duke sjellë aspekte më thelbësorë të ndërveprimit të lirive me njëra-tjetrën dhe me realitetet bashkëkohorë. Njëherazi me këto, u sollën shembuj përfaqësues, të vlershme për t'u ndjekur nga të gjithë, por edhe situata të ndërlikuara në kontekst të diversitetit dhe bashkekzistencës midis feve e besimeve.

Ka qenë Presidenti i Institutit Amerikan të Paqes, Nancy Lindborg, i cili fillimisht u ka uruar mirëseardhjen të pranishmëve, duke i ftuar të gjithë të japin

mendimet dhe idetë e tyre, apo duke mëtuar të japin mundësi zgjidhje rreth vështirësive të mundshme. Ndërsa përfaqësuesi i lartë i USAID, Bonnie Glick, në fjalën e tij midis të tjerave nënvizoi rolin e feve dhe besimeve në marrëdhëniet midis tyre. Ndërkaq, në sesionin e përgjithshëm, ku u fol për sfidat e sotme të lirisë fetare, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, duke marrë fjalën, solli shembuj nga zhvillimet fetare në Ballkan dhe Shqipëri. Midis të tjerave, ai u shpreh: "...Për mendimin dhe gjykimin tim, kur diskutojmë për sfidat e mëdha, në kuptimin e lirive fetare,



mendoj se duhet të jemi më të hapur në pranimin e feve apo besimeve të njeri-tjetrit. E vërteta është se ligjërata fetare, përgjithësisht pranohet se jemi bij të Ademit, se kemi një Zot të Vetëm dhe mëshira apo bujaria e Tij, na takon të gjithëve dhe na mjafton të gjithëve. Ky formulim mund të dëgjohet sot nga tempujt më të largët deri tek zemra urbane e kryeqyteteve tanë dhe, tingëllon mjaft bukur. Por ne shqiptarët, kemi një proverb shekullor, i cili na kujton të gjithëve: “Nga e thëna, në të bërë, shkon në mes një lum i tërë.” Pra, ka një vijë ndarëse, shumë të theksuar, midis realiteteve akademike, fetare apo sekularë, kundër rrjedhave të së vërtetës praktike. Po u jap një shembull konkret, të nderuar miq! Në cilësitë e Kryegjyshit Botëror Bektashian ka së paku tetë vite rresht që merrem me aftin e teqesë bektashiane në Tetovë, në Maqedoninë e Veriut. Ndonëse kjo teqe, me dokumente të rregullt të perandorisë osmane prej 500 vitesh u përket bektashinjve, përpara 15 viteve u uzurpua me dhunë nga një grup ekstremistësh syni, shqiptarë edhe këta të familjes së madhe myslimane. Duke qenë në esencë të prirur për harmoni dhe paqe fetare, ne kemi kontaktuar me dhjetëra herë me këta ekstremistë-uzurpatorë, por nuk kemi pasur asnjë rezultat konkret. Ndërkaq, u jemi drejtuar për ndihmë instancave më të larta shtetërore të Maqedonisë së Veriut, udhëheqjes së Bashkësisë

Islame atje, si dhe gjithë trupit diplomatik të akredituar në Shkup, me shpresë largimin e ekstremistëve dhe ushtrimin lirisht të besimit tonë fetar, por asnjë zgjidhje nuk rezulton. Ju drejtuam edhe gjykimin në Gjykatën e Strazburgut ku fituam të drejtën e mohuar pas kaq e kaq kohe, pas publikimit dhe dokumenteve të shumë pronorë, madje edhe pas djegies së një pjese të teqesë nga ekstremistët-barbarë dhe denoncimeve këtu në Departamentin Amerikan të Shtetit dhe sërish gjendja mbetet e nderë.

Paradoksalisht, edhe lidhshipi i Dijanetit Mysliman të Turqisë, në vend që të na japë ndihmën e nevojshme, mban kontakte me ozurpatorët e teqesë dhe bën plane për ndërrim destinacioni, për ta shndërruar atë objekt 5 shekullor në xhami osmane. Ne bektashinj të nuk kemi qenë dhe nuk jemi kundër xhamive. Madje, bashkëjetesa e xhamisë me teqenë e ka zanafillën në teqenë tonë të

parë, në Haxhi Bektash të Turqisë, e çelur 800 vite më parë. Në Azi dhe në Europë, por sidomos në Ballkan, në një truall të përbashkët, për nevojat shpirtërore të një komuniteti të caktuar, bashkëjetojnë ende sot xhamitë e teqetë, sepse tek e fundit, i përkasin Islamit, familjes së mrekullueshme të tij. Por për sa kohë që xhamia duhet të lartësohet për të lënë në hije teqenë (apo siç po ndodh në Tetovë për ta zhdukur fare), atëherë duhet parë se na mungojnë konceptet më bazike të lirive fetare. Në themel të çdo demokracie, është sendërtuar ideja e famshme se “liria ime mbaron atje ku fillon liria e tjetrit”. Aktualisht, edhe në këto momente që flasim,



në Maqedoninë Veriore, një grusht ekstremistësh syni, jo vetëm që kanë kurajën që të vrasin lirinë fetare të komunitetit bektashi, por çuditërisht marrin mbështetje nga mekanizma të ndryshëm brenda këtij shteti, apo jashtë tij duke shkelur mbi një trashëgimi shekullore dhe duke nxitur konflikte fetare pa asnjë motiv. Ja pra të nderuar miq pse u ndala në këtë çështje. Kemi vatra terrorizmi në Lindjen e Mesme dhe përpiqemi t'i shuajmë. Por po na ndizen vatra të tjera në Ballkan dhe bëjmë sikur nuk i shikojmë.”

Ndërsa në ditën e dytë të ministerialit, në sesionin e organizuar për ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore të komuniteteve fetare, Kryegjyshi Botëror, ndau me të pranishmit idenë se kjo trashëgimi e vyer në të vërtetë, vlen të përbëjë bazën e çdo konteksti të sotëm, kur flitet për “prurjet e mëdha” sekulariste dhe kushtet e globalizmit gjithëpërfshirës. Më tej, ai tha: “Sig-



të cilave sot, në shumë vende të botës është jo vetëm i trishtueshëm, por do të thosha i mjerë. Në këto shtëpi ët Zotit dhe të Haxhi Bektash Veliut, dikur kishte aq shumë gjallëri, prisnin dhe përcillnin me miliona besimtarë, ishin shndërruar në streha të paqes shpirtërore dhe asaj fizike, sot pjesa më e madhe e tyre janë të rrënuara, të mbyllura apo me destinacione thjesht turistike-historikë. Rasti më i veçantë është në Turqinë e sotme, ku teqeja e parë bektashiane, e themeluar në shekullin e 13-të, me gjithë vlerën e saj fetare dhe historike është jashtë funksionit të vet fillestarë. Ndonëse shërben si muze dhe përdorimi i sajë është në dorë të Ministrisë së Kulturës, atje ka një konflikt të hapur

urisht termi 'kulturë fetare' është mjaft i gjerë. Brenda tij kuptohen jo thjeshtë elementët përbërës të kësaj kulture, por edhe ndërveprimi i këtyre elementëve me njeri-tjetrin në kohë dhe hapësirë, marrëdhënie me etni e kultura të tjera, si dhe diversitetet natyrore në breza. Ne bektashinjtë kemi kultivuar dhe vazhdojmë të përcjellim një traditë kulturore shumë të ndjeshme, si në pikëpamje të doktrinës fetare ku frymëzohemi, ashtu edhe të mbështetur në sensin e kohës. Studimet e shumta për lëvrimin e kësaj kulture, i kemi ndërthurur me zhvillimet në etni të ndryshme dhe përgjatë rrjedhave historike, duke mbajtur të paprekur esencën kulturore dhe duke zbuluar elementët që kanë motivuar dhe ngjizur këtë trashëgimi. Ndonëse e shtrirë në tetë shekuj, trashëgimia jonë kulturore ka ruajtur identitetin e saj brenda kulturës universale të Islamit, madje shpesh herë, në situata të caktuara është njësuar për mrekulli me trashëgiminë më të vyer myslimane. Selia e Shenjtë Bektashiane, me qendër në Tiranë-Shqipëri, ka ndërmarrë këto 20 vite të fundit një sërë masash, për të gjetur, hulumtuar dhe evidentuar hap pas hapi çdo lidhje besimi apo tranzicioni, me të vetmin qëllim, për të risjellë këtë trashëgimi në zhvillimet dhe praktikatat e sotme, në atë masë që e lejon vetë koha. Rregullisht, çdo vit ne organizojmë në Tiranë, simpoziume ndërkom-bëtarë, me studiues të bektashizmit nga e gjithë bota, të cilët prezantojnë punimet e tyre, me çdo aspekt të tarikatit bektashian. Por ne gjithashtu mendojmë se trashëgimia kulturore ka një lidhje të veçantë me objektet e kultit tonat, me teqetë bektashiane, fati i

midis miliona besimtarëve bektashinj të Turqisë dhe këtij të ashtuquajtur, muze, sepse ndalimi i ushtrimit

Historikisht dihet tanimë se tarikatet janë jo vetëm pronë, por edhe pasuri e pallogaritshme e Islamit. Në këtë këndvështrim ne mendojmë se çdo përpjekje, sakrificë apo trend i yni në kontekst të trashëgimisë, nuk duhet parë si tentativë për "sulme" ndaj myslimanëve të tjerë, përkundrazi si thirrje për t'u bashkuar me individualitetet tanë në detyrat e shenjta që kemi ndaj Zotit. Të shpërndarë në më shumë se 31 vende të botës së sotme, Selia e Shenjtë Bektashiane përpiqet të mbajë kontakte të vazhdueshme me qeveritë përkatëse duke dashur jo thjeshtë të ruajmë, por edhe ta pranojmë trashëgiminë kulturore të komuniteteve tanë fetare.

të lirisë fetare, përbën një akt të pashembullt për qytetërimin e sotëm. Pa u ndalur në faktin e mbylljes së teqeve bektashiane në vitin 1925 në Turqi, pa dashur të analizojmë disa qëndrime gati ekstremiste të myslimanëve, ndaj myslimanëve të tjerë, se si Seli e Shenjtë Bektashiane kemi kërkuar prej 20 vitesh prej Ankarasë, ideimin dhe vënien në jetë të një pakete ligjore, që jo vetëm do t'i rihapte qindra teqetë tona atje, por do të rinisnin jetën e tyre shpirtërore miliona besimtarë turq


me origjinë familjare bektashiane. Historikisht dihet tanimë se tarikatet janë jo vetëm pronë, por edhe pasuri e pallogaritshme e Islamit. Në këtë këndvështrim ne mendojmë se çdo përpjekje, sakrificë apo trend i yni në kontekst të trashëgimisë, nuk duhet parë si tentativë për “sulme” ndaj myslimanëve të tjerë, përkundrazi si thirrje për t’u bashkuar me individualitetet tanë në detyrat e shenjta që kemi ndaj Zotit. Të shpërndarë në më shumë se 31 vende të botës së sotme, Selia e Shenjtë Bektashiane përpiqet të mbajë kontakte të vazhdueshme me qeveritë përkatëse duke dashur jo thjeshtë të ruajmë, por edhe ta pranojmë trashëgiminë kulturore të komuniteteve tanë fetare. Gjej rastin sot, të falënderoj nga zemra Shtetet e Bashkuara të Amerikës, jo vetëm për përkrahjet e vazhdueshme në veprimtarinë fetare të teqesë bektashiane në Detroit-Michigan, por edhe të krijimit të mundësive reale që mijërat e besimtarëve tanë ushtrojnë çdo ditë në mjediset e këtij objekti kulturi.”

Gjatë ditëve të zhvillimit të këtij ministeriali, Kryegjyshi Botëror Bektashian, u takua edhe bisedoi me shumë prej liderëve të lartë fetarë apo personalitete të tjerë në Departamentin Amerikan të Shtetit. Bisedat tejte frytdhënëse, ai kreu me: Dr. Muhammad Ilyes, udhëheqësi i dialogut të lirisë fetare në Pakistan, Prof. Dr. Nasaruddin Umar, udhëheqës i programit nacional kundër terrorizmit në Indonezi, Daniel Hontrop, përgjegjës në zyrën e të drejtave të njeriut në Departamentin e Shtetit, znj. Johnna Carlson, përgjegjëse e stafit për çështjet e jashtme, Faisal Fulad, sekretar i përgjithshëm i organizatës për të drejtat e njeriut në Bahrein etj. Kryegjyshi Botëror, vlerësoi lart nismat dhe përpjekjet e tyre në rrafshin e përparimit të lirive fetare, të të drejtave të njeriut, të mjedisit si dhe punën kolosale në çrrënjosjen



e varfërisë. Ai i njohu ndërkaq bashkëbiseduesit me zhvillimet e fundit në Selinë e Shenjtë Bektashiane, duke dhënë një tablo të qartë të veprimtarive të shumta që lidhen jo thjesht me realitetet bektashiane, por edhe me vëllazërinë fetare. Një takim shumë mbresëlënës, Kryegjyshi Botëror Bektashian, bëri edhe me mikun e tij, zëvendës-presidenti i Kongresit Hebraik Amerikan Dr. Munir Kazmir, me të cilin kënaqësinë e vlerësimeve për tarikatën bektashiane.

Koresp. “Urtësia”





ENTUSIAZËM PËR ARRITJET TUAJA!

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, priti në Seli, në Tiranë, znj. Mariyam Cementwala, këshilltare e politikave dhe nismave strategjike për çështjet e lirisë së besimit në Departamentin Amerikan të Shtetit

Përpara disa ditësh, Kryegjyshi Botëror Bektashian, priti në Seli në Tiranë, znj. Mariyam Cementwala, këshilltare e politikave dhe nismave strategjike për çështjet e lirisë së besimit në Departamentin Amerikan të Shtetit, me kërkesë të kësaj të fundit. Në të vërtetë, biseda u quajt e nisur që në SHBA, kur Kryegjyshi Botëror, në DASH në ministerialin e përvitshëm, kishte diskutuar në një seancë të veçantë dëgjimore lidhur me sfidat e lirive fetare në kontekstin ballkanik, duke bërë me dije, të pranishmit për realitetet e atjeshme.

E interesuar për zhvillimet e sotme në Selinë e Shenjtë, znj. Cementwala kërkoi të njohje me veprimtarinë botërore bektashiane në këto 30 vitet e fundit, pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri e më gjerë. Ajo u shpreh se ishte në dijeni të përpjekjeve të bëra dhe e entuziazmuar, veçanërisht në aspektin e respektimit të lirive fetare, çfarë nënkuptonte një bashkëpunim më të ngushtë të përhershëm jo vetëm me instancat ligjore përkatëse të shtetit, por dhe me organizatat e tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë, me institucione të rëndësishëm konstruktive si dhe brenda komuniteteve të besimtarëve. Ne e kemi çmuar vazhdimisht kontributin e bektashinjve në Ballkan e më gjerë, ndaj duam sinqerisht të bashkohemi dhe

të unifikojmë prioritetet e sotme të lirive fetare, në këtë trevë të jugut të Europës, pa harruar asnjë çast harmoninë fetare që ekziston prej shekujsh në vendin tuaj- u shpreh ajo.

Në bisedën e tij, Kryegjyshi Botëror Bektashian, në radhë të parë, vlerësoi kujdesin e vazhdueshëm të Departamentit Amerikan të Shtetit, për ndihmën e çmuar që i ka dhënë dhe vazhdon tu japë shqiptarëve në përgjithësi dhe paskëtaj komunitetit bektashian, si në Shqipëri, ashtu dhe në Kosovë e Maqedoninë e Veriut. Sa i përket Selisë së Shenjtë Bektashiane, vijoi Kryegjyshi Botëror, në fillim të viteve 30-të të shekullit që lamë pas, ajo u vu në krye të komunitetit të saj, duke rizgjuar para së gjithash frymën e shenjtë të Zotit, se pa atë, pa vullnetin e Krijuesit, asgjë nuk mund të arrihet. Ishte pikërisht ky rizgjim që bashkoi në një kahje të vetme entuziazmin e besimtarëve, me urtësinë dhe vendosmërinë e atyre pak klerikëve që mundën t'i shpëtonin gjallë diktaturës, çfarë bëri të mundur hapjen e teqeve, ngritjen nga themelet të atyre që u shkatërruan, rikthimin e traditave dhe vlerave më të spikatura të vijimësisë, në rrugën doktrinale bektashiane. Kjo bëri që në kaq pak vite, radhët e gjata të besimtarëve apo pelegrinëve të Haxhi Bektash Veliut t'u drejtohen teqeve, tyrbeve, apo vendeve të tjerë të shenjtë, duke u lutur, duke marrë shpresë, duke u vëllazëruar akoma më shumë me njëri-tjetrin dhe duke respektuar çdo besimtar tjetër, pavarësisht kujt feje apo race i përket. Sepse në thelb të tarikatit bektashian, në esencë të filozofisë së tij, ka qenë dhe mbetet dashuria për të gjithë ata që besojnë tek Krijuesi.

Më tej, duke u ndalur në shtrirjen e mëtejshme të bektashinjve, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e

Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, u shpreh: "Duke e konceptuar lirinë fetare si e drejtë themelore për çdo njeri, ne kemi qenë shumë të kujdesshëm në afrimin e besimtarëve. Prioritetet tona kanë qenë fryma e lirisë, përshtatja e kodeve zakonore me realitetet që jetojmë, përpjekja për të denoncuar çdo shfaqje të radikalizmit apo ekstremizmit fetar, çka ka bërë që

objektet tona të kultit të shndërrohen në vatra të shpresës dhe vëllazërimit. Ne numërojmë sot më shumë se 31 shtete me të cilat kemi lidhje të vazhdueshme në pikëpamje të organizimit dhe frymëzimit të komuniteteve bektashianë. Nga Ballkani në Azi, nga Europa dhe deri në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, këto komunitete paqësorë kanë dëshmuar dhe dëshmojnë dita-ditës bashkëjetesën dhe harmoninë e mrekullueshme me komunitetet e tjerë fetarë."

Ndërsa lidhur me problemet e kohëve të fundit në teqenë "Harabati-Baba" në Tetovë, Kryegjyshi Botëror u shpreh: "Sikundër bëra me dije edhe organizmat në Departamentin Amerikan të Shtetit një muaj më parë, jemi të shqetësuar për cenimin e ushtrimit të lirisë fetare në Maqedoninë Veriore, posaçërisht në teqenë tonë në Tetovë. Uzurpimi i kësaj teqeje nga një grup radikalësh myslimanë,

mbajtja e territoreve tanë me forcë dhe kërcënime, nuk është vetëm shkelje e rriteve, por cenimi më i rëndë që i bëhet lirisë, demokracisë dhe vetë ekzistencës së shtetit ligjor. Ndonëse ne u jemi drejtuar gjykatave të vendit, ndonëse ligjërisht i kemi fituar të gjitha betejat me radikalët, deri në Strasburg, ende organizmat e shtetit ligjor manifestojnë indiferencën e tyre, duke lejuar agravimin e situatës konfliktuale. Sidoqoftë, ne kemi vazhduar dhe vazhdojmë të jemi paqësorë, përballë çdo provokimi, madje edhe fizik, sepse gjykojmë se me paqe e korrektësi do të mund të zgjidhim çështjen, duke i rikthyer teqesë bektashiane në Tetovë, lavdinë e sajë pesë shekullore, duke ruajtur ndërkaq edhe nderin edhe dinjitetin e familjes myslimane së cilës i përkasim."

Znj. Cementwala e falënderoi Kryegjyshin Botëror Bektashian për pritjen e ngrohtë, për fjalët dhe perceptimet e tij dhe e inkurajoi të ecë si deri më sot, në rrugën e paqes e bashkëpunimit në të mirë të besimtarëve dhe lirive universale.

Koresp. "Urtësia"



Në Shembërdhenj, ku bektashizmi ka rrënjë të lashta



Nga Kujtim BORIÇI

Zig-zaget e rrugës që gjarpëron shpateve të një pas njëshëm, të veshura me pyje e gjelbërim, për në teqenë e njohur të Shëmërdhenjit, të duken si më ‘të buka’ kur shikon automjete të shumtë që mëngjesin e 6 gushtit 2019, kanë vetëm një kahje, atë drejt majës ku ndodhet dhe vendi i shenjtë. Por ka dhe shumë besimtarë, kryesisht të fshatrave më të afërt që ecin në këmbë. Ndalojmë diku në rrugë, tek një burim e takojmë disa besimtarë që janë ndalur pak, siç thonë, ‘të marrim frymë’. Njëri prej tyre, rreth të 80-tave që na thotë se quhet Zyber Zajmi, pasi përshëndetemi dhe urojmë njeri-tjetrin për këtë ditë të shënuar, në bisedë e sipër na thotë: “E bëj shpesh këtë rrugë, për tek teqeja e jonë e Shëmërdhenjit, qajmë hallet

atje me dervish Xhelalin, marrim shpresë e dritë për mbarësi në jetë. Por sot është ditë e shënuar, është dita e pelegrinazhit të përvitshëm. Kam ardhur familjarisht, vet i nëntë, me fëmijë, nipër e mbesa. Jemi nisur që në saba nga shtëpia për të shmangur vapën, nuk e kemi larg, është më pak se dy orë. Kështu kanë bërë dhe të tjerë nga fshati jonë, por ka dhe shumë që vijnë me makina. Nuk ndjejmë lodhje jo. Na japin forcë shenjtorët tanë, na mbanë adhurimi dhe shpresa tek Zoti i Madh e i Plotfuqishëm. Atij i falemi!”. Në vazhdim ai thërret pranë vetes nipin e tij të vogël, 8-9 vjeç. Na thotë që i kanë vënë emrin Ali dhe se dëshiron të ndjekë shkollën e të bëhet dervish. “Kemi pasur e kemi disa myhibë në fisin tonë, dëshirojmë që ky të mësoj e të veshë harkanë?- shton më tej i moshuari.

I afrohemi hyrjes së teqesë. Atmosfera festive e kësaj dite të shenjtë pelegrinazhi duket që nga



pjesëmarrja, tek kurbanet që vazhdojnë të piquen në hell, tek këngët bektashiane që përhapen nga autoporlantët e mëdhenj e përplasen masivisht pyjor, deri tek impenjimi i dervish Xhelal Resultit që kalon nga një grup besimtarësh tek një grup tjetër. “Kanë ardhur e vijnë këtu nga gjithë zona, por dhe nga qytete e krahina të tjera. Është bërë traditë që masivisht, në këtë ditë pelegrinazhi, vijnë breza të ikurish, deri dhe emigrantët që punojnë në vende të ndryshme të botës, i lenë pushimet në kohën që përkon me pelegrinazhin”- na thotë mes të tjerave dervish Xhelali.

Në këtë festë bektashiane, ka ardhur edhe Klodian Taçe, kryetari i sapozgjedhur i Bashkisë Gramsh. Ai sapo ka bërë betimin dhe ky pelegrinazh, siç dhe po-hoi, është dalja e tij publike në funksionin e kryevendorit. Kryegjyshi Botëror Bektashian, Dede Edmond Brahimaj, pas përshëndetjeve dhe urimeve të rastit gjen kohë e diskutojnë së bashku dhe për problemet e infrastrukturës në objektet bektashiane që shtrihen deh zhvillojnë aktivitetin në kufijtë administrativ të Bashkisë Gramsh.

Në ceremoninë e rastit, në fjalën e tij, mes të tjerave Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj tha midis të tjerave: “Në historinë e bektashizmit botëror, teqeja e Shëmbërdhenjt, këtu në këmbë të malit të bekuar të Tomorit, ka një vend të veçantë. E themeluar më shumë se tri shekuj më parë, oborri i kësaj teqeje do të mblidhte myhibë dhe dervishë, jo vetëm nga fshatrat për rreth Tomorit, por edhe nga Pogradeci, Korça Kolonja

Gramshi dhe Elbasani, të cilët të dashuruar me doktrinën e Haxhi Bektash Veliut, do të donin në mënyrë të skajshme Zotin, familjen dhe Shqipërinë tonë. Pavarësisht mërive etnike, pavarësisht trazirave politike dhe historike, teqeja e Shëmbërdhenjt, mbeti e pastër në misionin e saj madhor, për edukimin brezave, duke iu bashkuar mozaikut të mrekullueshëm të objekteve tona të kultit. E tillë vazhdon të jetë ajo edhe sot. Emrat e nderuar të baba Mustafa Braçit, baba Saliut, baba Hysenit dhe baba Ilmi Kurtezit, padyshim që janë krenaria më e thellë e këtij vendi dhe kujtesa historike e kësaj treve bektashiane. Në mes të këtyre emrave, brezat e sotëm dhe të nesërm, do të përulën ndërkaq me respekt, në mënyrë të veçantë, përpara kujtimit të veprës së baba Meleq Shëmbërdhenjt, këtij patrioti të dorës së parë, jeta e të cilit u shkri për besimin dhe kombin shqiptar. Për veprën e baba Meleqit është shkruar dhe folur shumë. Sepse në të vërtetë, kudo ku shkeli këmba e këtij kleriku bektashian, telte dritë dashuria për atdheun. Unë sot do t’ju sjellë në këtë përshëndetje vetëm disa vargje, të shkruara nga baba Meleqi, ku thotë midis të tjerave: “Tinëzaret po më ndjekin,/ Unë s’e kursej veten,/ Sikur në zjarr të më pjekin,/ Se harroj dot mëmëdhenë./ Çika-çika të më grijnë,/ S’më dhemb shpirti një thërrime,/ Ndonjë turp mua s’më gjejnë,/ Vdes për mëmëdhenë tim.”. Ne krenohemi me besimin tonë jo thjeshtë për historinë që kaluam. Shpesh na duhet të kthejmë kokën prapa për të rikujtuar sakrificat jo vetëm të klerikëve, por dhe të myhibanëve dhe dashamirësve. Por unë mendoj, se edhe sot,

në këtë ditë, ka vend për sakrificë, të cilat na mbajnë të hapura dyert e teqeve. Vite më parë, ky vend këtu ishte vetëm një grumbull rrënojash e shkurrësh. U desh sakrificë e klerikëve tanë, dervish Xhelal Resulit, u desh mbështetja jonë dhe e juaja njëkohësisht që të rikthehej lavdia e dikurshme e teqesë së Shëmbërdhenjit. Për këtë, i uroj dervish Xhelalit jetë të gjatë në shërbim të besimit bektashian. Ndërkaq, e shoh të pashkëputur nga kontributi i klerikëve edhe ndihmën e pakursyer që na japin sot myhibët dhe dashamirësit tanë të mrekullueshëm. Sikundër kam bërë dhe herë të tjera kur kam qenë kështu midis jush, në cilësitë e Kryegjyshit Botëror Bektashian, dua dhe sot të kujtoj dhe vlerësoj kontributin e z. Ferit Skora (qoftë i pavdekshëm kujtimi i tij) familjes së tij, të cilët vite më parë e kthyen këtë vend në kopsht me fruta, me forcën e krahëve të tyre; si dhe myhibëve, besimtarëve e dashamirësve të tjerë, kontributi i të cilëve bëri që në këtë vend të bekuar të vijë uji i bollshëm përmes maleve dhe kjo shtëpi e Allahut të jetë sa më e ngrohtë për besimtarët. Përfitoj gjithashtu nga rasti sot, tu bëj thirrje dhe tu bekoj që të forcojmë më shumë besimin në të Madhin Zot, të duam e respektojmë më shumë njeri-tjetrin pa dallim bindje, besimi apo etniteti, të falim më shumë dashuri, paqe e mirësi, ashtu si besimtarë të përkushtuar në udhën e bekuar të Pirit tonë, Haxhi Bektash Velit. Se më tepër se kurrë, situatat e vështira që po kalojmë sot në Shqipëri, por dhe në Europë e më gjerë, kërkojnë më shumë ndershmëri, besim tek Allahu, mirësi e paqe.”

Në vazhdim, përshëndeti dhe Kryetari i Bashkisë Gramsh, z. Klodian Taçe: “Jam i lumtur të jem sot midis jush në këtë ditë të gëzuar pelegrinazhi, që është takimi i



Përfitoj gjithashtu nga rasti sot, tu bëj thirrje dhe tu bekoj që të forcojmë më shumë besimin në të Madhin Zot, të duam e respektojmë më shumë njeri-tjetrin pa dallim bindje, besimi apo etniteti, të falim më shumë dashuri, paqe e mirësi, ashtu si besimtarë të përkushtuar në udhën e bekuar të Pirit tonë, Haxhi Bektash Velit. Se më tepër se kurrë, situatat e vështira që po kalojmë sot në Shqipëri, por dhe në Europë e më gjerë, kërkojnë më shumë ndershmëri, besim tek Allahu, mirësi e paqe.”

parë zyrtar publik për mua pas zgjedhjes në këtë detyrë. Falënderoj Kryegjyshin Botëror Bektashian, Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj për kontributin që ka dhënë për teqetë që shtrihen në territorin tonë por për bektashizmin në Shqipëri e në gjithë botën. U uroj të gjithëve mbarësi, paqe, dashuri të pakufishme e shpresë tek Zoti! Unë e di se infrastruktura, sidomos rruga automobilistike që të bie në këtë vend të shenjtë është e amortizuar dhe e vështirë. Shpresojmë që të gjemë rrugët e mundësitë që shpejt ta realizojmë këtë projekt” - pohoi mes të tjerave z. Taçe.

Dreka bektashiane dhe festa vazhduan deri në mbrëmje, teksa dielli filloi të largohej, për t’ia lënë vendin mbrëmjes...

Vlerësim i merituar për bektashinjtë

Kryeministri i Kosovës z. Ramush Haradinaj i dorëzon Kryegjyshit Botëror Bektashian, Hirësisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, medaljen e 'Heroit Kombatar', "Gjergj Kastrioti Skënderbeu"

Ditën e hënë, më 29 korrik 2019, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, u prit me nderime të vaçanta në mjediset e Kryeministrit të Kosovës. Veprimtaria, pothuajse historike e 30 viteve të fundit të Selisë së Shenjtë Bektashiane, shtrirja e tij tarikati në dhjetëra vende si dhe mendimi i çmuar që ka përshkruar doktrinën e këtij tarikati të Islamit përgjatë shekujve, ishin objektet e bisedave me shtetarë dhe lider fetarë të Kosovës. Nuk mungoi në këto biseda edhe harmonia e mrekullueshme fetare në Shqipëri, ku kontributi i bektashinjtë ka qenë kurdoherë i spikatur, duke mbështetur çdo nismë paqësore në këtë rrafsh dhe duke qenë në radhët e para të atyre që ndërtojnë ura paqe midis feve dhe besimeve.

Pas këtyre bisedave, ka qenë ish-Kryeministri i Kosovës, z. Ramush Haradinaj, i cili ka falënderuar të pranishmit në këtë ceremoni dhe veçanërisht Kryegjyshin Botëror Bektashian, Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj. Ai foli për tempullin e shenjtë të bektashinjtë, për atdhedashurinë e tyre në çdo kohë dhe vendin e merituar që tarikati bektashian zë sot në mozaikun fetar në Ballkan. Në fund, u shpreh: "Në shenjë respekti për punë e palodhur në

lartësimin e vlerave të traditës kombëtare, temave mbarëshqiptare, kulturës shpirtërore, kultivimin e tolerancës ndërfetare përmes udhëheqjes së komunitetit bektashian, i dorëzoi sot, Kryegjyshit Botëror Bektashian, Hirësisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, medaljen 'Gjergj Kastrioti-Skënderbeu'. Ta gëzoni!"

Nga ana e tij, Kryegjyshi Botëror Bektashian, e falënderoi z. Haradinaj për nderin dhe vlerësimin që i kishte rezervuar. Ai falënderoi pjesëmarrësit e tjerë dhe kumtoi midis të tjerave se "Kjo medalje, pavarësisht se më jepet mua, shkon sot për veprën e madhe të gjithë klerikëve bektashianë, të cilët në veprimtarinë e tyre fetare dhe njerëzore, nuk e ndanë asnjëherë Zotin nga kombi. Ata ishin dhe mbetën ndërtues e frymëzues të asaj kulture shpirtërore, që sendërtoi mendimin kombëtar shqiptar, përballë rreziqeve që kaluam. Ne do të dimë të ruajmë frymën e tyre dhe do të kontribuojmë deri në fund për vëllezërit tonë etnike dhe fetare, për të ecur drejt familjes europiane me identitetin tonë fetar."



Të dashuruarit në bektashizëm


Nga Baba Rexhepi

Sipas bektashinjve dhe të gjithë mistikëve të tjerë, dashurues është ai që përmban në veten e tij dashurinë e Zotit dhe shkrihet e digjet fare për Të. Është ai që, për hir të kësaj dashurie, është mbret dhe bëhet rob, dhe çdo vegël të trupit e sakrifikon për këtë ideal. Është ai njeri për të cilin Nesimiu thotë, në vjershat e tij, që sekretet dhe gjendjen e tij nuk mund t'i kuptojë askush, përveç atij që bie në valët e kësaj dashurie. Dashurues është ai njeri që, kur gjithë bota vdes, ai mbetet tërë jetën i gjallë dhe i pavdekur.

Dashurues është ai njeri që ka brenda thesarin e diamantit në veten e tij dhe i zbulohet. Me fronin e këtij diamanti fluturon në hapësirë si Salomoni, fluturon si Xhafer Tajari nga grumbulli i popullit dhe shkon në pozitën e mbetjes hyjnore (Beka billah). Është ai që e quan për lartësi dhe arrin gëzimin më të madh, kur digjet për të dashurin e tij, siç e përshkruan vjershëtori Hasan Ajniu. Dashuruesi në një rreze të vetme shikon diellin të tërë: në një fytyrë të vogël shikon krejt përfytyruesin dhe në një farë të thjeshtë kupton gjithë pemën.

Njeriut të papjekur, gishtin duhet t'ia afrosh në sy pa mezi ta shikojë; kurse dashuruesi, një bërthamë të shikoj; në të sheh dhe njeh frutin e saj. Nga ajo ndjen shijen dhe erën e saj. Nga ajo kupton trungun e saj, degët, fletët, frutin dhe të gjitha i përfytyron një gjë të vetme, e cila është zhvilluar dhe ndryshuar në lloj-lloj formash, të dala vetëm nga një bërthamë. Trupin e dashuruesit, që është si shkopi i thatë, kur i hyn dashuria, e ngjall me kokë e me të gjitha gjymtyrët, dhe e bën të lëvizë si shkopi i Profetit Moisi (a.s.), i

cili nga një shkop u bë gjarpër i madh që trembi botën. Dashuruesi shihet në lëmin e dashurisë, qërohet dhe pastrohet. Pastaj bluhet në atë dashuri, mbruhet, piqet



dhe bëhet bukë. Pastaj, si kafshata gati për ta ngrënë, del përpara botës që ajo të përfitojë prej tij. Dashuruesi pasqyrës së zemrës i ka hequr pluhurin dhe e ka zier për dyzet vjet në kazanin e dashurisë, aq sa e ka tretur fare dhe s'ka mbetur gjë brenda. Në atë

I lloj pasqyre ç'të tregojë i dashuri i tij ajo duket, qoftë i dashuri vetë ose dashuruesi. Dashuruesi shpirtin e tij e ka lartësuar me moralin e dashurisë dhe me pjekurinë e tij. Kështu është pastruar dhe është bërë gati të japë llogari kurdoherë që i kërkohet prej Zotit.

Këtë gjë e shpreh edhe Nesimiu me fjalët e tij:

“Dita e llogarive erdhi, çë sot, çë nesër!

“Më mirë ngreu, jepe llogarinë që të vjen patjetër”.

Me pak fjalë, mistikët bektashinj e shpjegojnë me lloj- lloj forma dashuruesin, por, që ta përmbledhim, dashuruesi është ai që e ka djegur veten e tij fare me zjarrin e dashurisë hyjnore, është shkrirë në të dhe është bërë lëng. Lëngu i tij ka mbetur atje, në fronin e të dashurit, pikërisht si thonë mistikët islamë: Shkrirja te Zoti (fena fillah) dhe mbetja tek Ai (Beka Billah).

I dashuruar, sipas misticizmës bektashiane, quhet Zoti i Madh, Krijuesi i të gjithë botës. Për këtë të dashur hyjnor vjershëtorët mistikë thurin lloj-lloj vjersha e gazele për të kënduar bukurinë e Tij, madhërinë e Tij, të cilën e shohin dhe e ndjejnë aq afër sa e zeza e syrit nga e bardha, pikërisht sipas fjalës hyjnore:

“Ne jemi më afër te ju nga sa është damari i qafës suaj”.

Nga zjarri i tepërt që ndjejnë për këtë lloj dashurie, ata e përfytyrojnë këtë në çdo farë forme, herë si mbret, herë si engjell, sipas shfaqjeve të imagjinatës poetike të tyre. Dhe për këtë thonë: I dashuri është Ai që qarkullon në syrin e dashuruesit. Ai që i ka pushtuar zemrën, e ka dehur dhe e ka bërë tamam si të pirë, aq sa kur shikon përrreth nuk sheh gjë tjetër përveç Atij. Dhe në pasqyrë, kur shikon dhe sheh veten e tij, nuk i duket gjë tjetër veç Atij. Në çdo gjë Atë shikon, Atë ndjen, Atë shijon dhe veten e tij vetë atje e gjen. Domethënë se, kur e shikon të dashurin, dehet aq fort sa edhe veten e tij vetë e di se e ka atje, të shkrirë në atë dashuri. Me këtë dehje i duket se që të dy shkëlqejnë me një dritë të pakufishme, e cila, si ylberi, ndriçon botën me lloj-lloj ngjyra të ndryshme dhe i jep shije dhe erë të këndshme.

Bukuria e të dashurit për të ka mbuluar qiellin, dheun dhe ka qarkuar gjithë universin. Ai është trandafili që ka mbuluar kopshtin e zemrës së tij dhe e deh me

erën e këndëshme.

Dashuria për këtë lloj të dashur është një sekret për të dashurin, është një ndjenjë shpirtërore, të cilën si e përshkruan ashtu i paraqitet. Si i vihet në dukje, ashtu e imagjinon dhe e paraqit, pikërisht siç thotë vjershëtori:

“Format m’i ndryshove soje- soje ngjyra,

Të më humbaç mendjen, të mos të të njoh!

Kudo që të futesh, në sadofytyra,

S’më shpëton nga sytë, un’ kudo të shoh!”

Për këtë lloj dashurie, një mistik tjetër ka thënë:

“Mbështetu tek Ai dhe mos u dëshpëro. Vetën dorëzoja të dashurit dhe mos mbaj për vete asnjë dëshirë. Tërheqja e të dashurit bëhet kur të mos bësh asnjë kundërshtim, asnjë pretendim. Gjithë dashurinë t’ia hedhësh Atij dhe mos mbash asnjë thërrime dashuri për tjetër gjë veç Atij”.

Ja edhe një tjetër mistik: “Një dashurie që piqet mirë në dashurinë e të dashurit të tij, Zotit të Madh, mundimet e popullit dhe dëmin i quan lavdi, varfërinë e quan mburrje dhe lartësi”.

Që ta përmbledhim, i dashur i vërtetë quhet Ai, të cilin dashuruesi nuk e barazon me asnjë shije tjetër, sikur edhe parajsja vetë të jetë. Çdo gjë të shenjtë të vetëm e ka sakrifikuar për Të, qoftë në këtë botë, qoftë në botën tjetër. As veten e tij dhe asgjë tjetër nuk gëzon përveç të Dashurin e Vërtetë, Zotin e Plotfuqishëm. Për këtë tezë, ja se ç’thotë Nesimiu:

“Çdo orë të dashurin përshëndes.

“Më zë në grykë, pa Të s’më rrihet!



“S’më shijon as pija, më keq më ndez,
 “Po s’jesha me Të, asgjë s’më zihet”.

Për dashuruesin nuk ka rëndësi të thotë për të dashurin e tij: Ky është i dashuri im. Rëndësi për të ka kur i dashuri vetë thotë: “Ky më dashuron mua. Unë ia çmoj, e dua dhe e dashuroj”. Atëherë dashuruesi, kur arrin në këtë gradë, kënaqet aq fort, sa asgjë tjetër s’ka vleftë më për të. Të dy botët sikur t’ia falësh nuk i vlejnë as sa balta e këpucës të Dashurit të tij. Fitimi i luftës së dashurisë për dashuruesin është vetëm kur ndjen ndonjë erë të re të së vërtetës, gjatë kësaj rruge, dhe gjen gjurmët e të dashurit.

Mbi këtë tezë, Sejid Nizami (poet bektashi) thotë:
 “Të qoftë tynë bota që shikon,
 “Për mua një dost, një post mjafton”.

I dashuri nuk kërkohet në misticizmë poshtë e lart. Ai është i mbyllur në veten tënde, sipas fjalës së Profetit të Madh Muhamet (a.s.):

“Kush ka njohur veten e tij, ka gjetur dhe ka njohur Perëndinë, të cilën nuk e ka larg nga vetja”.

Këtë pikë e kanë theksuar shumë mistikë islamë me vjershat e tyre dhe e kanë shpjeguar gjatë e gjerë, sa s’lënë pikë dyshimi.

Po këtë teori e ka shprehur edhe Naimi i ynë në “Lulet e Verës” me vjershën e tij:

Kërkonja gjetkë ta gjeje
 Zot’n e Madh e të Vërtetë!
 Ay qënkej ndaj meje,
 E paskesha unë vetë!”

Sipas interpretimit të mistikëve bektashinj, dashuruesi dhe i dashuri janë gjithmonë së bashku dhe s’mund të ndahen. Janë, siç thamë më sipër, si delli kryesor i trupit, pa të cilin s’mund të jetojë trupi. Pra duhet të jetë i bashkuar. Këtë gjë e krahasojnë si shpirtin me trupin, që njeri pa tjetrin nuk mund të jetojnë. Po të mos ishte kështu, atëherë fjalët dashuri, dashurues dhe i dashur do të ishin fjalë goje, që do të ekzistonin vetëm në emër.

Siç dihet, qëllimi i dashuruesit është të mbërrijë tek i dashuri. Për këtë bën çdo sakrificë, humbet fare ekzistencën e tij dhe shkrihet krejt deri sa të mbërrijë tek Ai. Në këtë rast esencat zhduken, çdo dallim largohet dhe bëhen një të dy. Atëherë ajo gjallëri e përjetshme, ajo esencë e madhe, të cilën nuk e nxuri bota

e tërë, as qielli, as dheu, u fronëzua dhe zuri vend mu në zemrën e dashuruesit të tij, e shenjtëroi atë dhe e bëri Qabënë e të gjithë besimtarëve. Kështu dashuruesi në një kohë bëhet dashurues dhe në një kohë i dashuruar vetë. Këtë tezë e kanë trumbetuar jo vetëm poetët mistikë bektashinj, por edhe gjithë mistikët islamë.



Drita e Shkëlzenit

Nga Nuri Çuni

Nga Gjyshata e Fushë Krujës në javën e parë të gushtit, nisemi me dervish Sali Petin, sekretarin Sadik Balla dhe shoferin e talentuar Muharrem Pajtani, me një ndjesi të veçantë për të vajtur në vendin e shenjtë të Sarisalltikut në Shkëlzen të Tropojës. Herët në mëngjes udhëtojmë në rrugën e kombit, kalojmë Kukësin në malësinë dhe lëmë Kalimashin drejt Ragamit për në Tropojë. Bisedat janë të ngrohta, dervish Saliu bën humor dhe rrugën e gjatë e bën më të lehtë. Sadik Balla është i interesua për Malësinë e Gjakovës, gjeografinë dhe historinë e saj. Po, i them Sadikut aq sa dimë, gjeografia dhe historia e Malësisë së Gjakovës janë interesante dhe të njohura jo vetëm në Shqipëri por edhe Ballkan. Tropoja (Malësia e Gjakovës) shtrihet nga Qafa e Agrit e deri në Qafë Morinë, ajo përbëhet nga Gashi, Krasniqja, Bytyçi, Berisha, Shipshani e Nikaj-Merturi. Ka një sipërfaqe të përgjithshme 1143 kilometër katror dhe mbizotëron relievi kodrinor, malor, gropat e lashta më e madhja është ajo e Tropojës që duket qartë nga maja e Shkëlzenit ku është Vëndi i Mirë i Sarisalltikut.

Historia e saj është e lavdishme në shekuj. Nuk ka patur moment historik kombëtar, pa praninë e tropojanit, kjo si rrjedhojë e kësaj treve liridashëse

e cila njihet historikisht nga etja për kulturë e dije, një shtjellë shpirtërore e zotëruar nga intelijenca e vitaliteti. Bashkëjetesa e respekti për të tjerët është virtyti kryesor i tropojanëve, gjithmonë të bashkuar në luftra e kudo, madje me prirje të thellë për t'u integruar. Shkolla e parë shqipe në Gjonpepaj 111 vjet më parë, njihet si e para në Malësinë e Gjakovës. Por Tropoja historikisht është e konfirmuar si zemra e Malësisë së Gjakovës. Sepse u kanë ndriçuar mendjen dhe rrugën krejt banorëve të asaj treve, në të gjithë rrugëtimin e tyre historik prej shekujsh për të mbrojtur dhe ruajtur identitetin e tyre, gjuhën e tyre, zakonet e tyre, për të ruajtur dhe për të pasuruar vlerat e tyre morale. Pasi kalojmë Ragamin dhe dalim në qafë të malit, duket Tropoja dhe Shkëlzeni i madhërisëm. Bukuri të veçantë në mëngjesin e bukur të kësaj dite do ta përjetojmë dhe kënaqësinë e paharruar të kësaj mrekullie natyrore. Na pret me buzagaz dhe fjalët e ngrohta mirëseardhjeje kryetari i Shoqatës "Drita hyjnore e Shkëlzenit", z. Besfort Tafaj, i cili u na falënderoj për pjesëmarrjen në pelegrinazhin e ditës së shënuar në Shkëlzen, me që shkonim nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane. Ashtu së bashku duke kaluar në rrugën e vështirë të ngjitjes së malit Shkëlzenit, z. Besfort tregon: "Në rrethin e Tropojës, shtrihet madhërisëm në pjesën lindore të tij mali i Shkëlzenit. Madhështisë e bukurisë i shtohet dhe



shenjtëria, besimi i hershëm. Që në shekullin e XIV gjer në ditët e sotme, ky vend i shenjtë është vizituar masivisht në Vendin e Mirë të Shkëlzenit. Ky vend i shenjtë ka krijuar besim tek njerëzit që e vizitojnë. Vendi i Mirë ndodhet në lartësinë 2417 m mbi nivelin e detit. Ka hapësira të mëdha dhe pamje, ky vend shprese dhe qetësie shpirtërore për njeriun, pret miq nga Tropoja, Hasi, Kukësi, Puka dhe mbarë Kosova. Vijnë nga të gjithë moshat ku ka njerëz me probleme, halle dhe sëmundje të ndryshme. Shpesh shumë nga këta kalojnë dhe një natë aty. Vitin e kaluar u hap rruga e makinës, gjë që krijoi lehtësira për ta vizituar çdo njeri. Sivjet po punojmë për ta çuar udhën deri të Vendi i Mirë, duhet edhe një kilometër me gjerësi 5 metra. Ai uron: “Fati dhe mbarësia u ultë në sofrat tuaja, në sofrat tona të dashurisë së Ehli-Bejtit”.



E vërteta është se shoqata e tij ka bërë këto vite një punë të madhe në hapjen e rrugës dhe propagandimin e këtij vendi të shenjtë, duke u lidhur me të gjithë organizmat e pushtetit vendor në Tropojë dhe Qarkun e Kukësit, dhe me përkushtim po punon për të mbajtur gjallë vlerat e besimit. Studiuesit e mëdhenj të shqipes akademiku Eqrem Çabej, dr. Rexhep Krasniqi nga Tropoja, Mahir Domi, Xheladin Gosturani, filologu Avdyl Sula kanë dhënë studime interesante për etnokulturën e malësisë së Gjakovës etj. Këto studime e bëjnë shumë interesant edhe njohjen e Vendi të Mirë Sarisalltik në Shkëlzen. Rexhep Belit, i thoshnin edhe baba Rexhep Beli, i cili ka patur një kulturë të lartë dhe ka lënë gjurmë në këtë trevë. Është e vërtetë që vepra e mirë është mirënjohja më e thellë por duhet thënë që këto histori të shkruhen dhe trashëgohen. Një popull që nuk e shkruan historinë e vet nuk mund ta njohë atë dhe po nuk e njohu siç ka qenë në të vërtetë nuk do të

dijë të ndërtoje të ardhmen e tij. Këta misionarë të paqes dhe përparimit kanë shërbyer dhe shërbejnë për reflektimin, edukimin dhe devotshmërinë në rrugën e jetës.

Dervish Sali Peti në grupin e madh të pelegrinëve bashkë bisedon dhe u uron fat, shëndet dhe mbarësi në familjet e tyre, duke u shprehur: “ Kemi gati tri dekada që më çdo 7 gusht mblidhemi në Shkëlzenin tonë, në këtë vend të bekuar, në këtë ditë të shenjtë, si vazhdim i pelegrinazhit tradicional në shekuj. Ky pelegrinazh është jo vetëm një stacion i takimeve të mrekullueshme me historinë, por edhe vazhdim i bisedave me njeri-tjetrin me Vendin e Mirë, me hallet dhe gëzimet e pranishme në jetën fizike dhe atë shpirtërore. Ky vend i bekuar që na ka mbledhur sot, i rrethuar nga fryma dhe mirësitë e Shkëlzenit, ka shfaqur në shekuj shumë mrekulli. Por pa më të voglin dyshim, mrekullia më e madhe e këtij vendi është frymëzimi që ai u ka dhënë brezave tropojar


“
Përkujtimi në këtë ditë të shenjtorit të madh Sarisalltik merr një rëndësi për islamin dhe tarikatet në Shqipëri dhe në botë. Zoti i Lartë qoftë i kënaqur me devocionin tuaj dhe veprës së Ehli-Bejtit dhe u plotësoftë çdo dëshirë!”
 ”

të mrekullueshëm, për t'u dalë në çdo kohë, Zot, fatit të kombit të tyre dhe familjeve të tyre. Sikurse në hadithin profetik që thuhet se: “dashuria për atdheun kalon nga besimi” kjo ka bërë që në çdo kohë, sado e vështirë të ketë qenë ajo, burrat e kësaj treve e kanë thënë fjalën e tyre të mençur, e kanë shfaqur trimërinë e tyre të skajshme dhe tolerancën fetare. Unë jam i bindur se kjo tolerancë e shqiptarëve mbahet në dy shtylla të fuqishme, të cilat janë dashuria në të Madhin Zot dhe dashuria për atdheun. Këto dy shtylla, nuk kanë lënë askurrë ne shqiptarëve të luftojmë njeri - tjetrin, përkundrazi ta respektojmë, ta duam, të jemi në vëllazëri shekullore jo vetëm me njeri – tjetrin por edhe fqinjët tanë. Sigurisht të orientuar nga mëshira universale, nga dialogu, nga paqja. Miliona myslimanë në botë e dinë shumë mire se surja e parë e Kuranit quhet Fatiha, që do të thotë: hapje, fillim. Sepse ne po trokasim në dyert e Evropës me hallet tona por edhe me identitetin tonë fetar, me tolerancën tonë të shkëlqyer. Përkujtimi në këtë ditë të shenjtorit të madh Sarisalltik merr një rëndësi për islamin

dhe tarikatet në Shqipëri dhe në botë. Zoti i Lartë qoftë i kënaqur me devocionin tuaj dhe veprës së Ehli-Bejtit dhe u plotësoftë çdo dëshirë!” Burimet historike tregojnë se Sari Salltiku ishte dërguar në Ballkan me porosi të vetë Haxhi Bektash Veliut. Historia e teqeve ka nisur në Shqipëri shumë herët, fillimisht në Krujë, në malin e Krujës, Shkëlzen, Mali Pashtrik, Mamuras, Laç, Shijak, e deri në Sarandë. Gjithashtu, në Pejë të Kosovës, Prizren, Ohër të Maqedonisë, Greqi në Korfuz e Çamëri dhe Bosnjë Hercegovinë. Gjeografia e shteteve ku ka vepruar Sarisalltiku është në një hapësirë të gjerë; në Azi, Evropë dhe Afrikë, por epiqendra e veprimit të tij padyshim ka qenë Anadoli dhe Ballkani. Historia flet për Vendlin e Mirë të Shkëlzenit, ka derishi ynë ka shfaqur mrekullitë e veta.

Respektojmë me udhëtimin tonë të përbashkët edhe klerikët e njohur, të paharruar dervish Luzha, dervish Rexhep Beli e të tjerë klerikë nga Gjakova. Por kur vete të Vendi i Mirë radhët e gjata të pelegrinëve përulen me respekt dhe bëjnë ritualin tradicional, në majë të Shkëlzenit një natyrë mrekulli, hap krahët e lumturohesh kur përreth shikon malet e lartë dhe Gjakovën e Tropojën në perëndim maja e Jezercës, 2694 metra, maja e Hekurave 2581 metra. Mrekullohesh dhe merr uratën dhe mirësitë e këtij vendi të shenjt në këtë ballkon të alpeve të Shqipërisë. Ashtu me plot dashuri dhe respekt na përcjell z. Besfort dhe na qeras me ëmbëlsirën, revaninë e kësaj ditë dhe një shoku i tij na jep boronica të mbledhura në këtë zonë. Dita e Shkëlzenit na la mbresa të thella dhe shpirti hyjnor i atij mali i jep gjithsecilit energjinë dhe uratën për mirësi dhe dashurinë e të gjithëve.





SHPIRTI I DLIRË I IMAM HYSENIT A.S

Beteja në shkretëtirën buzë Euftratit ishte në zgrip. I larti Imam Hysen, kur pa se të gjithë shokët e vëllezërit iu vranë, i mbetur vetëm në fushën e mjeruar të Qerbelasë, rënkoj aq shumë sa e dëgjoi qielli dhe toka. Gratë e derës së Ehli-Bejtit kur panë të madhin Imam Hysen që mbeti i vetëm e pa njeri, ranë përtokë duke klithur. Pamja e këtij momenti zemërdjegës në atë fushë të mjeruar nuk ishte shfaqur ndonjëherë. Në një anë qanin e vajtonin bijat e shkreta, në anën tjetër motrat e dashura, gruaja Sheri Banuja dhe i vogli Zenel Abedini. Ky, kur pa të atin vetëm e pa njeri në fushën e mjeruar të Qerbelasë, u ngrit menjëherë nga krevati dhe, duke u dridhur prej etheve të vapës, armatohet mirë e kërkon të dalë në fushën e betejës.


Kur pa djalin e sëmurë të armatosur gati për të dalë në fushë të luftës, Imam Hyseni e kapi dhe i tha: „O dritë e syve të mi! Ty nuk do të lejoj të dalësh të luftosh, sepse nuk mund të mbyllet dera e Ehli-Bejtit pa një mashkull.” I larti Zenel Abedin, pa mëdyshje i përgjigjet: „O ati im i dashur! Vëllezërit e mij, të gjithë kanë vdekur dhe kanë shkuar në Parajsë, po unë pse nuk mundem?” Të gjitha gratë ia plasën vajit me të madhe. I larti udhërrëfyes i gjithësisë, duke e përkëdhelur, pëshpërit: „O copë e zemrës simë! Ty ende nuk të ka ardhur radha për të shkuar në fushën e bukur të Parajsës.”

Pastaj i larti Imam Hysen thërriti pranë vetes Zenel Abedinin dhe i dorëzoi sekretet e trashëguara nga i ati e gjyshi, Kuranin Mexhidi, Kuranin Fatime, Shifrin Ebjas, Shifrin mbi përmbledhjen e përmbysjen e botës. Po

“

Unë jam djali i gjyshit dhe atit që janë më të lavdërueshit e të gjithë botës. Unë jam një pasardhës i lindur nga dy florinj. Unë jam bir i një burri që ndërsa kombi Kurejsh vinin rrotull dhe faleshin përpara idhujve Luth e Asam, ky që në vegjëli, i falej fytyrës së bukur të Perëndisë. Cili është ai njeri që ka një gjysh si imi që ka qenë dritëdhënës i diellit e i hënës dhe i gjithë yjeve?

“



kështu i dorëzoi edhe disa sekrete hyjnore që, përveç dymbëdhjetë imamëve nuk mund t'i përmblihte njeri tjetër në botë. Si bëri këto dorëzime, me qëllim që të shkonte në Parajsë i qetë, u përgatit, veshi rrobat më të bukura dhe harkan më të mirë, mori mburojen e hekurt të të lartit Hamza, ngjeshi shpatën Zylfikar të të madhit Ali dhe i hipi atit me bajonetën në dorë. Të gjitha grave sa nuk u ra të fikët kur e panë. I larti Imam Hysen, i vetëm përpara një ushtrie të madhe të armikut u mbështet mbi bajonetën e tij dhe tha: Unë jam djali i gjyshit dhe atit që janë më të lavdërueshit e të gjithë botës. Unë jam një pasardhës i lindur nga dy florinj. Unë jam bir i një burri që ndërsa kombi Kurejsh vinin rrotull dhe faleshin përpara idhujve Luth e Asam, ky që në vegjëli, i falej fytyrës së bukur të Perëndisë. Cili është ai njeri që ka një gjysh si imi që ka qenë dritëdhënës i diellit e i hënës dhe i gjithë yjeve? Cili është ai njeri që ka një baba si babai im, i cili vrau e copëtoi tradhtarët në betejat ngadhënjyese e Bedrit e të Hynejnit? Cili njeri ka një nënë si e imja që ka qenë dritë e syve të të madhit Muhamet? Cili njeri ka një xhaxha si xhaxhai im Xhaferr Tajari që ka fluturuar? Unë jam i krijuar prej diellit e hënës, se babai im ishte dielli e nëna ime ishte hëna. Nëna ime ishte e ditura e Profetit dhe trashëgimtare e atij që është më i larti i gjithësisë. O ju ndjekësit e të madhit Profet! Ju besimtarët e shtëpisë së Ehli-Bejtit! Gëzohuni se nesër në jetën e përtejme do të pini nga dora e pastër e Hysenit ujin e ngjalljes dhe lëngun e pastër!

Pas këtyre fjalëve të vërteta dhe plot mendim, imami ynë, u kthye dhe u tha: „O ju kombi i mundimdhënës. Nuk keni frikë nga Perëndia, e cila popullin e Firaunit e mbyti në ujërat e Nilit dhe ngatërrestarët e Filit i vrau me gurë me anë të zogjve Ebabil? A keni frikë prej atij

Zoti që zhduku malësorët e popullit Lut ndërsa kundër-shtarët e Profetit Nuh i bëri të vuajnë? O ju gjakpirës! Në qoftë se besoni në atë Perëndi dhe te Profeti, që është gjyshi im, hiqni dorë nga këto të këqia që po bëni. Mendoni fundin e jetës suaj. Pra jepini fund veprave të këqia duke më lënë të lirë të shkoj bashkë me fëmijët dhe gratë nga ana e Abisinisë, ose Rumisë e t'ju liroj juve viset e Arabisë dhe tokën e Hixhasit e të Ebabilit. Në qoftë se nuk do t'i pranoni këto fjalë dhe në qoftë se me doemos doni të luftoni me mua, atëherë të paktën që mund të bëni, dilni një nga një në fushën e luftës.”

Fjalët zemërpërvëluese bënë të qajnë jo vetëm njerëzit, por edhe kafshët. Disa nga rradhët e ushtrisë armike filluan të mallëngjehen. Por të mallkuarit Buhteriu, Shimri, Shithi e të tjerë që ushqenin një urrejtje të madhe për shtëpinë e Ehli-Bejtit, kur panë se ushtarëve të mallëngjyer po u thyhej zemra, i dalin përpara trimit gojëmjaltë dhe me guxim të madh i thonë: „O Hysen! Lufta jonë bëhet me urdhër të Jezidit. Shpëtimi juaj është t'i bindeni atij, ose të përgatiteni për fundin tuaj.” Pas këtyre fjalëve u hodhën shigjetat e para mbi Imam Hysenin. Por mbrojtja hyjnore bëri që asnjë shigjetë të mos e kapte Imamin e madh. Ai shihte me habi sulmin e rreptë të armikut dhe shigjetat që binin si pikat e shiut. Papritur u bë një errësirë e madhe, sikur po përmbysesj bota. U shfaq një trup i tmerrshëm, i çuditshëm, me

kokën si të një gomari dhe këmbët si të luanit, i cili i erdhi pranë të lartit Imam Hysen dhe duke fshirë sytë në këmbët e tij, i thotë: „Es-selamy alejke ve ala ebiqeq, ve ala xhedyqeq”, që do të thotë: „Qoftë shpëtimi mbi ty, atin e gjyshin tuaj!”

I larti Imam Hysen, udhërrëfyti i njerëzve i përgjigjet „Qoftë shpëtimi edhe mbi ty! O ti fatbardh i çuditshëm! Kush jeni ju që në këtë errësirë pusi doni të ndihmoni

një njeri të mbetur vetëm?” Ai i përgjigjet: “O nip i të Dërguarit të Perëndisë! Unë jam mbreti i i hijeve të kësaj ane, mua më quajnë Zaferi Xhini. I larti ati juaj, luani i Perëndisë, i madhi Ali, kur në luftën e divave, me anën e zyflikarit vrau ata, atin tim e kishte emëruar mbret dhe unë si trashëgimtar i tij, jam mbret i hijeve të kësaj zone. Prandaj më jepni leje që t’i godas këta armiq për të këqijat që ju kanë bërë.” I larti mbret i dy jetëve i thotë: “O Zafer! Jam tepër i gëzuar për dëshirën dhe sinqeritetin që tregon ndaj nesh, por meqenëse jeni hije e pa trup dhe meqenëse nuk ju shohin njerëzit, është padrejtësi që t’ju jap leje të luftoni me njerëz. Unë nuk dua të bëj padrejtësi dhe nuk dua që ju të bëni gjëra të tilla nën emrin tim.”

Zaferi i thotë përsëri: “O udhërrëfyes i dy jetëve! Në luftën e Hynejnit engjëjt e ndihmuan gjyshin tuaj. Edhe ata ishin si ne të padukshëm nga njerëzit. I Dërguari i Perëndisë, i madhi Muhamet i kishte lejuar engjëjt ta ndihmonin në luftë. Më jep dhe ti leje të luftoj kundër këtyre gjakpirësve.” Përgjigjja e imamit ishte: “O Zafer! Muhametit nuk i kishte ardhur koha e vdekjes në luftën e Hynejnit, pra për shpëtimin e tij Perëndia dërgoi engjëjt ta ndihmonin. Por unë kam për t’u bashkuar me të dashurit duke e ditur mirë se duke kaluar nga kjo jetë, po shkoj në jetën e pafundme. Për një orë jetë nuk dëshiroj t’u jap mundime e vuajtje shokëve e miqve.” Pasi hoqi shpresat, Zafer Xhini, i la lamtumirën dhe u largua. Në çast errësira e madhe u zhduk papritur.

Si u largua errësira dhe u shfaq qielli i pastër, i larti Imam Hysen doli përpara armiqve dhe kërkoi luftëtarë për t’u ndeshur. Doli luftëtar i shtë

hur me emrin Nemim Kahtebeja, i cili i thotë: “O Hysen! Për ty është më mirë t’i bindesh Jezidit, sepse ti vetëm nuk mund t’ia dalësh dot kësaj ushtrie të madhe. Shumë ushtarë kanë armiqtë me ju, pasi dikujt i është vrarë vëllai, dikujt fisi e shokët.” Imami ynë përgjigjet: “O Shamas! Nuk e fillova unë luftën, por ju më vratë e më copëtuat të gjithë vëllezërit e shokët, fisin e gjithçka kisha. Në pamje të parë ushtria juaj duket e madhe, por në jetën e padukshme ushtria ime nuk ka mbaruar. Unë jam një mbret i lartë. Të gjithë engjëjt e qiellit dhe ata të tokës, të vegjël e të mëdhenj, njerëz e hije, kafshët e shpendët, janë nën hijen e flamurit tim e në udhërrëfimin tim dhe shkojnë në Parajsë, ndërsa ata njerëz që nuk më binden, shkojnë në Skëterrë. Shpresoj që dhe ju ta kuptoni këtë. Të gjithë do korrim atë që kemi mbjellë. Gjyshit tim kur e sulmuan armiqtë e ndihmuan engjëjt me fytyrë njerëzore. Në atë luftë për t’i shërbyer, morën leje prej gjyshit edhe atit tim, të madhit Ali për dashurinë që kishin për Perëndinë. Dhe Muhameti, me dorën e copëtuar theu portën e Hajberit, duke vrarë tradhtarin Amru Abdu. I dashuri Muhamet tha se sjellja e Aliut me zyflikarin është më e pëlqyeshme se të gjitha veprimet e besimtarëve të fesë.”

Në fund të këtyre fjalëve i larti Imam Hysen papritur bërtiti aq fort, sa ushtria armike u tmerrua. Nga kjo bërtitje u trondit toka e Qerbelasë. Në atë moment nxjerr shpatën dhe i pret kokën Nemim Kahtabes. Nga ushtria armike nuk guxonte të dilte asnjë të përballej me të. Pas pak kohe del në fushë të luftës Zejdi Ebrabi, i cili ishte trim i pari kryetar i lartit Hysen. Sapo

pa që doli ky në fushën e luftës e qëllloi menjëherë me shpatë dhe ia ndau në dysh trupin. Në këtë kohë, nga etja e madhe që kishte për ujë Imam Hyseni u nis për në Eufrat. Kur e pa Shimri i thotë ushtrisë: “O ju ushtarë shamas e të Qofes! Mos e lejon Hysenin të pijë ujë, se në qoftë se pi një herë ujë, të gjitha veprimet që kemi bërë deri tani, do na shkojnë kot.”

Sipas urdhërit të të mallkuarit Shimer, ushtria e sulmoi menjëherë të lartin Imam Hysen. I dashuri i Perëndisë, në një dorë mbante shpatën dhe në tjetrën mburojën e hekurt. Cilido që i dilte përpara e vriste dhe e copëtonte. Pasi shpartalloi tre rreshta ushtarësh, mundi të hynte drejt lumit dhe sa po bëhej gati të pinte ujë me grushta dëgjo një zë që i thotë: “O Hysen! Ushtria e armikut hyri në çadrat e grave për të grabitur gjithçka. Nuk është e arsyeshme që ju të pini ujë dhe armiku t’ju grabisë fëmijët, gratë dhe gjithçka.” Nga ky zë i larti Imam Hysen e derdhi ujin nga grushtat dhe u kthye për te çadrat. Pasi vrau e preu dyzet ushtarë që i kishin zënë rrugën erdhi pranë çadrave ku ishin gratë në gjendje të qetë. Atëherë e kuptoi që ai zë ishte nga ushtarët armiq me qëllime dhelparake.

I larti Imam Hysen nga plagët që kishte marrë, i rridhte gjaku si krua. Megjithatë, u afrua pranë çadrave dhe i thirri të gjitha gratë duke u thënë: “O ju gratë e derës së Ehli-Bejtit! Përgatituni se sot keni hidhërimin më të madh. Mos grisni rrobat, mos çirrni fytyrat, mos shkulni flokët, ruajeni veten tuaj nga të panjohurit.” Duke thënë këto fjalë, zuri të qajë e bashkë me të qanë edhe gratë. Paskëtaj, mori të dashurin Zenel Abedin dhe duke

fërkuar faqen e vet me të tijën u nda prej tij, duke i dhënë lamtumirë përgjithmonë: “O dritë e syve të mi! E di fare mirë se ju nuk do të ndaheni nga rruga e durimit, por ju këshilloj të jeni të fortë në rrugën e shpëtimit e të durimit, sepse e vetmja gjë që e shpëton njeriun është durimi dhe shpresa. Ta dini se vuajtjet janë shijimet e njerëzve të lartë. I qoftë shyqyr Perëndisë që na vuri në provë për vuajtjet e rënda! Të falat tuaja do t’ua transmetoj gjyshërve të mëdhenj, shpirtrave të shenjtë, shpirtrave të derës së Ehli-Bejtit, shpirtërave të dëshmorëve dhe të gjithë shpirtrave të Parajsës. Ashtu dhe ju ua dërgoni të falat e mia të gjithë shokëve e miqve që ndodhen në Mekë e në Medine dhe në viset e tjera të Arabisë.” Duke thënë këto fjalë, lotët i rridhnin në fytyrë si curril.

I larti Zenel Abedin dëgjonte fjalët dhe qante. Në këtë moment Sheri Banuja, kapi të lartin Imam Hysen prej harkaje dhe i thotë: “O mbrojtësi im dhe shkaktari i lumturisë sime! Unë jam e mbetura e vetme e një mbretërie të humbur e të zhdukur. Deri tani kam qenë fshehur nën hijen e krahëve të tua, kurse ju doni të shkoni të sakrifkoni jetën. Grave të derës së Ehli-Bejtit armiqtë nuk kanë për t’u bërë ndonjë gjë të keqe, por mua që jam e vetme e pa njeri, pale çdo të më gjejë!” Me ngashërim u shtri në këmbët e të lartit Imam Hysen. Ky, për ta ngushëlluar i thotë: “O Sheri Banu! Mos u hidhëro e mos u dëshpëro se edhe ti je në grupin e derës së Ehli-Bejtit. Dhe në asnjë mënyrë ty dhe grave të tjera të derës së Ehli-Bejtit, ata që ju njohin, nuk ka për t’ju bërë asgjë të keqe.” Kur i larti Imam Hysen po ngushëlonte Sherin Banunë, motrat, Ymyl, Ymyl dhe larti Zejnepe, filluan

të qanin me të madhe. Në çadrat e grave filloi vajtimi. Ai u la lamtumirën dhe u nis për në fushën e luftës. Me dhimbje, por edhe lumturi, imami po largohej nga kjo jetë, për të shkuar në jetën e pafundme.

Kur pa të lartin Imam Hysen që doli përsëri me trimëri të paparë në fushën e luftës, kryekomandanti i ushtrisë gjakpirëse ndaloi ushtarët të dilnin e të luftonin me të një nga një dhe u thotë: “O ju të paditur! Trimëritë e Mustafait dhe tmerret e Myrtezait sot janë mbledhur në trupin e Hysenit. Sikur të përmbledhet gjithësia në një trup dhe t’i dalë përpara Hysenit, me një goditje si ato të Hajdarit, ai do ta shembte menjëherë. Ndonëse Hyseni është dobësuar nga etja për ujë dhe prej plagëve e dëshpërimit të humbjes së të gjithë shokëve, sulmojeni të gjithë përnjëherësh.” Pas këtij urdhëri ushtria armike e rrethon nga të gjitha anët, por trashëgimtari i mbretit të elvijave dhe të luanëve me shpatën e tij vigane sulmonte në çdo anë të ushtrisë së armikut, duke i dërguar shumë prej tyre në Skëterrë.

Përflitet se i larti Imam Hysen shpartalloi edhe një herë rreshtat e ushtrisë armike e shkoi të shuante etjen pranë lumit Eufrat Mbushi grushtat me ujë dhe në atë çast iu kujtuan fëmijët e derës së Ehli-Bejtit që po digjeshin për të. Përnjëherësh e derdhi ujin nga grushtat. Flitet gjithashtu se, kur i larti Imam Hysen shkoi pranë lumit të shuante etjen, i mallkuari Hasir Temimi e qëlloi me një shigjetë, e cila i çau buzën e i theu një dhëmb. Nga kjo plagë ai nuk mundi të pijë ujë.


Ushtria armike vazhdonte të sulmonte pa pushim mbi të me shigjeta që ia bënë trupin shoshë. Imam Hyseni sa vinte e po dobësohej dhe po

e kuptonte se po i vinte fundi i jetës. Kur e pa veten keq u nis për tek çadrat. Kishte marrë shtatëdhjetë e dy plagë. Zbriti nga kali dhe ul në tokë. Sapo e pa që ai u ul, kryekomandanti Ymer Sadi e sulmon me shpatë për ta vvarë. I larti Imam Hysen i thotë: “Për të më prerë kokën erdhe ti, o biri i Sadit? Ky, i turpëruar nga fjalët e tij dërgoi ushtarë të tjerë, mirëpo luani i Perëndisë, Imam Hyseni u ngrit dhe i vrau. Më pas, nga plagët e shumta, u shtri përsëri në tokë. Kështu kjo shtyllë e lartë e drejtësisë, dielli i gjithësisë u nis për në kopshtin e bukur të Parajsës. Në atë minutë vajtimi mori dhenë. Gratë u rrëzuan në tokë nga të fiktët. Tregohet edhe se kur i larti Imam Hysen ishte i dobësuar lart në kalë, Shimri iu kishte thënë ushtarëve që ta sulmonin të gjithë së bashku.

Sapo ushtria e Jezidit mori vesh se Imam Hyseni nuk ishte në gjendje të mbrohej, një pjesë gjakpirësh sulmuan çadrat. I larti Imam Hysen ishte aty pranë dhe u bërtet: “O ju kombi i pa fé Sufjan! Me gjithë injorancën tuaj, së paku duhet të keni ruajtur çështjen e nderit. Nuk është e drejtë të veproni kundër grave, prandaj ndaleni këtë veprim!” Pas këtij qortimi, komandantët e ushtrisë së Jezidit i ndaluan ushtarët që po grabisnin çadrat dhe u sulën nga ana tjetër ku ishte imami ynë. Por nga madhështia që kishte treguar, askush nga ushtarët armiq nuk guxoi t’i afrohej. Krejt i pafuqishëm, i larti Imam Hysen zbriti nga kali që të mos e plagosnin dhe po ecte në këmbë. Kur e panë ashtu të dobësuar aq shumë ushtarët u sulën njëherësh dhe e qëlluan me shigjetë mu në mes të ballit. Gjaku i shumtë i mbuloi fytyrën. Atëherë i larti Imam Hysen i shiu fytyrën duke thënë se nuk mundi t’u dilte përpara

“

Qiellin e mbuloi një re e zezë duke e lënë vendin në errësi. Kjo mrekulli e natyrës u bë për të nderuar të lartin martir dhe pastaj fusha e mjerë u kthjellua. Tregohet se kur shpirti i nderuar i mbretit të dëshmorëve të Qerbelasë po shkonte në lulishten e Parajsës, të gjithë shpirtrat e shenjtë, të profetëve dhe engjëjve i dolën përpara të rreshtuar. Me këtë ceremoni shpirti i lartë i mbretit të dëshmorëve është paraqitur te Perëndia. Qoftë shpëtimi e falja mbi atë shpirt të pastër dhe mbi prindërit, vëllezërit e shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që ranë dëshmorë në fushën e Qerbelasë!



gjyshit, atit, nënës e vëllait me këtë fytyrë. Mbretit të dy jetëve, i erdhi koha për të dhënë shpirt. U kthye drejt kibles dhe po priste çastin për të rënë dëshmor.

Shigjetat e armikut nuk lanë pjesë të trupit pa e qëlluar. Ai u shtri i dobësuar së tepërmi, por i dha forcë vetes dhe u ngrit përsëri. Turma e ushtrisë, duke e parë ashtu të plagosur rëndë iu afrua për ta vrarë, por kur e shikonin ashtu të gjakosur, i largoheshin gjoja të turpëruar dhe nuk guxonin ta vrisnin. Shimri, i cili po shikonte nga larg se asnjë ushtar nuk guxonte ta vriste, egërsohet dhe u thotë: „O ju që u mungon guximi! Si nuk keni shpirt të thorni një njeri të mbetur vetëm?” Atëherë i mallkuari Dera Sheriqi e qëlloi më shpatë dhe i preu njërin krah, ndërsa i mallkuari Sinan Insi e goditi gjithashtu me shpatë. I larti Imam Hysen, shtylla e besës, simboli i ndershmërisë, u shtri në tokën e mjeruar të Qerbelasë. Sado që iu hodh t’ia priste kokën, i mallkuari Shebel

Houl, nuk ia arriti. Diçka e fre-nonte.

Në këtë moment kryekomandanti

Ymer Sadi dërgoi një ushtar t’i priste kokën, por i larti Imam Hysen i thotë: „Nuk jeni ju vrasësi im, mos u bëni vegël se nesër do të vuani vuajtjet më të mëdha.” Dhe ushtari ia kthen: „O nip i të Dërguarit të Perëndisë! Në këtë gjendje që jini, ende keni mëshirë për ne? Nuk kam më dyshim se ju, jeni ndër udhëheqësit e vërtetë. Dhe me shpatën në dorë iu sul kryekomandantit të ushtrisë, por u ndalua nga rojet e tij, të cilët e qëlluan për vdekje. Me plagë në trup iu afrua përsëri të lartit Imam Hysen dhe i thotë: „O Imam Hysen! Mua po më vrasin për ty”. Ky ia ktheu: „Punët e trimave nuk humbasin kurrë!” Me qëllim që të nderoheshin nga Jezidi, ushtarët e armikut nxorën shpatat dhe u hodhën si të tërbuar, mbi të dashurin e Perëndisë. Sinani i mallkuar donte që këtë punë ta fillonte ai i pari, por Shimri vrapoi më shpejt dhe i hipi të lartit Imam Hysen të larë në gjak, në kraharor.

I dashuri i Perëndisë, mbreti i dëshmorëve të Qerbelasë, hapi sytë dhe e pyet se cili ishte? Jam Shimri Xhousheni i thotë ai. Martiri i thotë të hiqte mbulesën e fytyrës që ta

shikonte. Shimri i hoqi mbulesën dhe i tregoi fytyrën e tij. Sapo e pa, Imam Hyseni i tha menjëherë: „Sadaka Resulall-llah”, pra sa e drejtë është fjala e Profetit”. Sepse Profeti Muhamet ia kishte treguar fizionominë e vrasësit të vet. Më tej ky i thotë të mallkuarit që i kishte hipur në kraharor: „O ti Shimer! Ti je vrasësi im. Çfarë muaji, dite dhe viti është sot?” Dhe Shimri i përgjigjet: „Është muaji i Muharremit. Sot është ditë e premtë dhe koha e të falurit të mesditës.”

I larti Imam Hysen i thotë: „O gjak-pirës fatzi! Në këtë muaj të nderuar e sidomos në një ditë të premtë si e sotmja dhe në faljen e mesditës, të gjithë besimtarët nëpër minbere po përmendin cilësitë e larta të gjyshit tim duke thënë: „Perëndia urdhëron të tregoni drejtësi te të afërmit e tij

dhe të largoni nga vetja sharjet e çnderimet e rënda që bëni ndaj tyre, se atëherë do të jeni më të qetë.”

Çdo muhamedan pak a shumë pendohet e falet në këtë ditë të uruar për të këqijat që ka bërë. Si guxoni të bëni një vepër kaq të poshtër? O gjakpirës i pamëshirshëm! Largohuni nga kraharori im, t’i lutem pak Perëndisë, sepse e kam trashëgim nga ati im, që të vritem tamam, kur të jem duke u falur dhe duke i lutur Perëndisë.”

I larti imam Hyseni u përpoq ta largonte nga kraharori Shimrin, ndonëse ishte i pafuqishëm.

Megjithatë i larti Imam Hysen u ngrit, iu drejtua kibles e iu fal dy herë Perëndisë me kokën ulur në tokë. Shimri, i penduar që i dha leje për t’u lutur, e godet me shpatë dhe i pret kokën. Nga kjo ngjarje e tmerrshme u trondit dheu dhe qielli.

Qiellin e mbuloi një re e zezë duke e lënë vendin në errësirë. Kjo mrekulli e natyrës u bë për të nderuar të lartin martir dhe pastaj fusha e mjerë u kthjellua. Tregohet se kur shpirti i nderuar i mbretit të dëshmorëve të Qerbelasë po shkonte në lulishten e Parajsës, të gjithë shpirtrat e shenjtë, të profetëve dhe engjëjve i dolën

përpara të rreshtuar. Me këtë ceremoni shpirti i lartë i mbretit të dëshmorëve është paraqitur te Perëndia.

Qoftë shpëtimi e falja mbi atë shpirt të pastër dhe mbi prindërit, vëllezërit e shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që ranë dëshmorë në fushën e Qerbelasë!

Pasi dha jetën i larti Imam Hysen, kali i tij duke parë të zotin të larë në gjak, u afrua pranë çadrave dhe në kohën kur ky po jepte shpirt largohet, duke iu humbur nga sytë, grave.

Këto po prisnin kthimin e të dashurit të shtrenjtë të çadtrat, por kur panë kalin që erdhi vetëm pa të zotin, filluan të të vajtonin. E larta Banu dhe disa gra të tjera iu afruan kalit Dhyl Xhenah dhe e shihnin në sy, sikur donin ta pyesnin se ku është i zoti. Dhyl Xhenahu hungëroi thellë dhe u largua nëpër fushën e shkretë, për mos t’u parë kurrë.

Në fushën e mjerë të Qerbelasë, së bashku me oshëtimat e largëta dhe të përjetëshme të betejës, bashkohen në dhimbjen më të thellë, hingëllima e një kali...

Abdylbaki Gylpinarli



Paqe e bekime mbi Ty!

Paqe e bekime mbi Ty, o biri i Fatime Zehrasë, së zonjës së bekuar të grave të botëve! Paqe e bekime mbi Ty, o shpaga e Allahut dhe i biri i shpagës së shpagueshme! Paqe e bekime mbi Ty dhe mbi ata shpirtra, të cilët zbresin dhe hynë në rreth e qarkun tënd, prej meje mbi Ju të gjithë. Paqe e bekime të Allahut përjetësisht, për sa qëndron nata dhe dita! O i ati i Abdullahut, u zmadhua fatkeqësia dhe u bë e tmerrshme me ty, mbi ne dhe mbi të gjithë botën islame!

U bë e tmerrshme dhe u zmadhua fatkeqësia yte me të gjithë banorët e qiejve! Pra Allahu e mallkoftë atë farë e fis që themeloi themelet e tiranisë dhe të vuajtjes mbi ju: Ehli Bejtin! Dhe e mallkoftë Allahu atë farë e fis që ju hoqi prej selisë tuaj dhe ju rrëzoi prej pozitave tuaja, pozita të cilat Allahu juve ua ka caktuar! Allahu e mallkoftë atë farë e fis që ju vrau juve dhe Allahu e mallkoftë atë farë e fis përgatitës me vendosmëri për vrasjen tuaj!

Largohem prej atyre, prej ndihmësve të tyre, ndjekësve të tyre dhe miqve të tyre! O ati i Abdullahut. Unë jam në paqe me ata që janë në paqe me Ju dhe jam në luftë me ata që ju luftojnë Ju. Deri në ditën e kijametit! Dhe Allahu e mallkoftë farë e fisin e Zijadit, farë e fisin e Mervanit, të gjithë bijtë e Ymijesë (Emevitë)! Dhe Allahu e mallkoftë të birin e Merxhanes, Allahu e mallkoftë Ymerin, të birin e Saadit, Allahu e mallkoftë Shimrin, Allahu e mallkoftë atë farë e fis që u pajis dhe vendosi dhe u përgatit për vrasjen Tënde!

Betohem me atin dhe mëmën time se u zmadhua fatkeqësia ime me Ty. Pra i lutem Allahut, i cili e lartësoi selinë tënde, dhe më lartësoi mua me Ty, të më përrarrije në hakmarrjen tënde me Imamin triumfues të Ehli-Bejtit, të Muhamedit (qoftë paqja e bekimi i Allahut mbi të dhe atin e tij!) Im Zot! Në praninë tënde më bëj mua të nderuar me Hysejnin në këtë botë dhe në të tejmen jetë, qoftë paqja e bekimi mbi Atë!

O ati i Abdullahut! Unë afrohem me Allahun, me Resulullahun, me kryetarin e besimtarëve (Myrtezai), me

Fahtime-Zehranë, me Hasan Myxhtebanë dhe me ty o Hysejn. Me dashurinë tënde, me largimin prej atij që të vrau Ty dhe vendosi luftën kundër teje dhe me largimin prej atij që themeloi themelet e tiranisë mbi ju, largohem prej atij që themeloi po atë themel dhe e ngriti mbi atë godinën e saj, që bëri guxim në tirani dhe në vuajtjet mbi ju dhe mbi Ndhimësat tuaj. Afrohem tek Allahu dhe tek Resulullahu.

Largohem prej atyre dhe afrohem tek Allahu dhe tek Ju! Dhe afrohem tek Allahu dhe tek ju, me dashurinë tuaj, me dashurinë e mikut tuaj dhe me largimin prej ndjekësve të tyre dhe prej ndihmësve të tyre. Unë jam në paqe me atë që është në paqe me ju dhe jam në luftë me atë që ju lufton Ju, jam mik me atë që ju dashuron ju dhe jam armik me atë që ju tregon armiqësi ju. Pra i lutem Allahut, i cili më lartësoi mua duke u njohur Juve dhe duke i njohur miqtë Tuaj. Më pajisi mua me largimin prej armiqve tuaj, të më bëjë mua që të jem bashkë me Ju në këtë botë dhe në të tejmen jetë, të më bëjë mua këmbëngulës të vërtetë pranë Jush, në këtë botë dhe në të tejmen jetë.

Gjithashtu i lutem Atij të më ngrëjë mua në selinë e lavdërueshme, e cila është për Ju, pranë Allahut dhe të më përrarrijë në hakmarrjen time me Imam Mehdinë, i cili është i dukshëm dhe ligjërues prej Jush. Pra i lutem Allahut për hirin tuaj dhe për atë pozitë që keni Ju pranë Atij, të më japë mua për fatkeqësitë tuaja, dhuratën më të preferueshme, e cila u jepet të prekurve në të tilla fatkeqësi, fatkeqësi kjo që është më e madhja në islamizëm dhe në të gjithë banorët e qiejve dhe të tokës. O im Zot!

Më bëj mua në këtë vend, prej atij që përfiton prej teje, urime, bekime, nderime. Im Zot! Bëje jetën time si jetën e Muhamedit, bëje vdekjen time si vdekjen e Muhamedit dhe si të Aliut të Muhamedit!

Im Zot! Kjo ditë është një asisoj dite, që përgëzojnë dhe e festojnë bijtë e ymijesë (emevinjtë), dhe i biri i mushkëri-ngrënësës, i mallkuar bir' i të mallkuarit me gjuhën e Profetit tënd: kudo që ky qëndroi edhe shkoi paqe dhe bekime qofshin mbi atë dhe mbi Aliun e tij!

Im Zot! Mallkoje Ebu Sufjanin dhe Muavijen, Jezidin të birin e Muavijes qoftë mbi ata mallkimi prej Teje, gjithmonë dhe përjetë! Kjo ditë është një e tillë dite që me atë përgëzohet farë e fisi i Zijadit dhe farë e fisi i Mervanit, me vrasjen që bënë ata kundrejt Hysejnit paqe dhe bekime qofshin mbi atë, mbi Aliun e Tij dhe mbi ndjekësit e Tij!

Im Zot!...Shumëfisho mbi ata (armiq) mallkimin prej Teje dhe ndëshkimin! Im Zot! Afrohem te ty në këtë ditë dhe në këtë vend, në ditët e jetës sime, duke u larguar nga ata dhe duke i mallkuar ata, dhe duke dashuruar Profetin Tënd dhe Aliun e Tij ,paqja e bekimet qofshin mbi Ata!

Im Zot! Mallkoje atë të parin tiran, që tiranizoi Muhamedin dhe Aliun e tij, dhe mallkoje atë të fundit ndjekës të kësaj tiranie. Im Zot! Mallkoji ata mëkatarë të cilët luftuan Hysejnin qoftë paqja dhe bekimi mbi atë!, ata që u grumbulluan, u bashkuan, u shoqëruan për vrasjen e Tij, mbi Atë.

Im Zot! Mallkoji të gjithë (ata armiq)! Paqe e bekime mbi Ty, o i ati i Abdullahut! Dhe mbi ata shpirtra të cilët zbresin e futen në rretheqarkun Tënd, qoftë mbi Ty prej meje, paqja dhe bekimi i Allahut: gjithmonë e përjetë sa qëndroj unë dhe të qëndrojë dita e nata, mos e bëftë Allahu të fundit për mua këtë vizitë. Paqe dhe bekime përmbi Hysejnin dhe përmbi Aliun, të birin e Hysejnit dhe mbi shokët e Hysejnit. Im Zot! Prije ti posaçërisht atë të parin tiran me mallkimin prej nesh dhe fillo në të parin të dytin... të tretin... të katërtin. Im Zot! Në të pestin, Jezidin, birin e Muavijes! Dhe mallkoje Ybejdin, të birin e Zijadit, të birin e Merxhanes, Ymerin të birin e Saadit dhe Shimrin, farë e fisin e Ebu Sufjanit, farë e fisin e Zijadit dhe farë e fisin e Mervanit deri në ditën e kijametit! Im Zot! Qoftë lavdia mbi Ty: Lavdia e falenderuesve të tu për të prekurit (e këtyre fatkeqësive), qoftë lavdia mbi Allahun për këtë fatkeqësinë më të madhe! Im Zot! Na bëj nasib shefaatit e Hysejnit në ditën e ardhjes dhe më bëj këmbëngulës të drejtë pranë Tij, bashkë me Hysejnin dhe me shokët e Hysejnit, të cilët sakrifkuan jetën e tyre për Hysejnin. Na bashko, O Zot, me Hysejnin, paqja e bekimi qoftë mbi Atë, për hirin e tij dhe për bujarinë Tënde!

O më Bujari i bujarëve! Përhirimet dhe bekimet e Allahut qofshin përmbi zotërinë tonë Muhamed, dhe mbi Aliun e Muhamedit, të cilët janë të pastër, të dlihtë e të pafajshëm. O Zoti i botëve! Lavdia qoftë mbi Allahun, Zotin e botëve!

Allah... Ejvallah... Hy Dost...



LET US BE UNITED FOR THE PRIORITIES OF THE RELIGIOUS FREEDOM

By the speech of the World Bektashi Grandfather, His Eminence Haxhi Dede Edmond Brahimaj, to the Ministerial on the religious freedom in Washington



tradition of religious harmony and peace, we contacted many times these extremists-usurpers, but we had not any concrete result. Meanwhile, we asked for help to the highest State institutions of the Northern Macedonia, to the leaders of the Islam Community in that country, as well as to all the diplomatic representatives accredited in Northern Macedonia, hoping to the removing away of the extremists and to the free practicing of our faith, but we did not found any solution. We asked also the judgment of the Strasbourg Court, which recognized our right which has been deprived for a long time, after the publication of many documents; a part of the tekke was burned by the barbarian extremists and we denounced this fact to the States Department of the USA, but the situation remains always a very tense one.


Paradoxally, even the Muslim Dijanet of Turkey, instead to give us the necessary help, keeps contacts with the usurpers of the tekke and makes plans to change its destination, converting the Bektashi tekke it in a Osman mosque.

We, the Bektashi people, we are not against the mosques. Indeed, the origin of the coexistence of a mosque with a tekke is our first tekke, opened 800 years ago in Haxhi Bektash, in Turkey. In

I think that when we discuss about big challenges in the sense of the religious freedom, we have to be more open to accept the religions or the faiths of the others. The truth is that, generally, in the religious discourses, is admitted that we are, all of us, sons of Adam, that we have an Only God and that His Mercy and Generosity belong to all of us and are enough for all of us. You can hear this formulation from the most remote temples until in the urban hearts of our capitals and it sounds very prettily. But, a very ancient albanian proverb says: "There is a big river between saying and doing". So, there is a separating line, a very


clear one, between the academic realities, religious or secular ones, and the practical developments of the everyday life. I give a concrete example, dear friends!

In the quality of the World Bektashi Grandfather, since at least 8 years I have to deal with the destiny of the tekke of Tetova, in Northern Macedonia. Though this tekke owns all the regular papers of the Ottoman Empire, dating since 500 hundred years, proving that it belongs to the Bektashi community, it was usurped, by violence, 15 years ago, by a group of Sunnite extremists, Albanians like the Bektashi people which are the heirs of the tekke. Respecting our



We, the Bektashi people, we are not against the mosques. Indeed, the origin of the coexistence of a mosque with a tekke is our first tekke, opened 800 years ago in Haxhi Bektash, in Turkey. In Asia and in Europe and especially in Balkans, in common territories, even nowadays, because of spiritual necessities of different communities, coexist yet mosques and tekkes, because, anyhow they belong to Islam, to His wonderful family.

Asia and in Europe and especially in Balkans, in common territories, even nowadays, because of spiritual necessities of different communities, coexist yet mosques and tekkes, because, anyhow they belong to Islam, to His wonderful family. But, when the mosque wants to mount up just to leave the tekke under the shadow (or, what is happening in Tetova, to annihilate the tekke), in such a case, we have to notice that the basic conceptions of the religious freedom are absent. In the foundations of the democracy is the famous idea "The end of my freedom is there where is the begining of the freedom of the other people". Actually, in Northern Macedonia, even in these moments that we are speaking, a handful of extremists sunnites, not only have the courage to kill the religious freedom of the Bektashi community, but, strangely, they have the support of the Dijanet of Turkey, of the Islam



Community of Northern Macedonia and of other structures of that country which pretends, rightly, to have its place in the great european family.

There are fire-places of terrorism in the Middle-East and we try to extinguish them. But other fire-places begin to burn in Balkans and we make as if we dont see them.

Here is, dear friends the reason why I spoke about this matter.



URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE
BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE
NR. 133 GUSHT 2019

